



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.02.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 22.12.2022, 19.01.2023).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. {...} dhe {...}, Inspektorë pranë Njësisë së Inspektorëve në ILD.

8. Të tjerë: Greta D, Vladimir Karaj (BIRN).

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 22.12.2022, 19.01.2023).

Ilir Rusi: Mirëmëngjesi të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë, sot është mbledhja e datës 13.02.2023, ora 11:00.

Për arsye objektive, kryetarja nuk është prezent, kështu që mbledhja do të drejtohet nga unë, Ilir Rusi.

Sipas rendit të ditës, pika 1 e saj është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit

disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, e cila është shtyrë nga mbledhja plenare e datës 22.12.2022 dhe 19.01.2023.

Administrata të njoftojë përfaqësuesit përkatës.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Mirë se erdhët!

Sipas autorizimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 2740/35, datë 10.02.2023, ka autorizuar znj. {...} dhe z. {...} (të dy prezent), me detyrë inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët së bashku përfaqësojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr.3/2022, në ngarkim të magjistratit {...}, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, në seancën në Këshillin e Lartë Gjyqësor të datës 13.02.2023, ora 11:00.

Në lidhje me magjistratin z. {...}, administrata ka bërë njoftimin përkatës nëpërmjet e-mail-it që seanca e radhës dëgjimore do të zhvillohet sot më datë 13 shkurt 2023, ora 11:00. Gjithashtu edhe me shkresë zyrtare është përcjellë njoftimi pranë qendrës së tij të punës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për të cilën marrja e kësaj dijenie është konfirmuar nga nëpunësja civile gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, znj. {...}.

Për më tej, me e-mail-in e datës 24.01.2023 na është vënë në dispozicion raporti mjekësor, në vijueshmëri të raportit mjekësor të mëparshëm të zotit {...}, i cili ka qenë në periudhën 05.01. deri në datën 20.01.2023, është paraqitur rishtazi raporti i radhës në periudhën 20.01.2023 deri në datën 4 shkurt 2023. Gjithashtu, me e-mailin e ditës së sotme, datë 13.02.2023, ora 09:²⁰, na është vënë në dispozicion, nëpërmjet postës elektronike, raporti mjekësor i radhës, në vijueshmëri të raporteve të mëparshme, nga data 04.02.2023 deri në datë 19.02.2023.

Për këto arsye të shprehura nëpërmjet raporteve, zoti {...} nuk është prezent në seancën dëgjimore të radhës.

Ju si përfaqësues të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, çfarë mendimi keni për vijimin e procesit?

Marsela Pepi: Nisur nga dokumentacioni që ka paraqitur magjistrati ne e lëmë në çmim të Këshillit të vendosi nëse duhet ta pranojë kërkesën për shtyrje apo jo. Megjithatë unë mendoj që ka një lloj tendence për të shtyrë këtë lloj seance (në perceptimin tonë). Kështu që nuk e di në qoftë se këto janë të vijueshme; e kanë atë pjesën që janë dy të përsëritura çdo 15 ditë secili. Nëse është e nevojshme që ne të kërkojmë informacione edhe pranë mjekut të familjes që i lëshon.

Ilir Rusi: Fjala për zotin Hado (relator).

Ridvan Hado: Raporti është raport mjeko-ligjor i lëshuar nga komisioni dhe janë në vijueshmëri.

Marsela Pepi: Dakord! Pranohet kërkesa.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Atëherë, në lidhje me datën e zhvillimit të seancës dëgjimore të radhës, zoti Hado, keni ndonjë propozim?

Ridvan Hado: Në kushtet kur zoti {...} nuk mund të paraqitet në seancën e sotme për arsye objektive, mendoj që seanca e ardhshme të jetë në datën 6 mars, ditë e hënë (nëse do biem dakord), ora 11:00.

Marsela Pepi: Dakord jemi.

Ilir Rusi: Jeni dakord?

Faleminderit!

Atëherë, seanca e radhës dëgjimore do të jetë në datën 6 mars 2023, ora 11:00.

Ju lutem administrata të bëj njoftimin zotit {...} personalisht nëpërmjet postës elektronike, njëkohësisht edhe dërgimin e njoftimeve përkatëse në qendrën e tij të punës, mbi zhvillimin e seancës dëgjimore të radhës, datë 6 mars 2023, ora 11:⁰⁰, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.02.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017–2019, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Të tjerë: Greta D, Vladimir Karaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017–2019, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore *znj. Brikena Ukperaj*.

Ilir Rusi: Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën dy të saj që është shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me relatore *znj. Brikena Ukperaj*, dhe për të cilin magjistratja {...} ka marrë dijeni.

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Gjyqtarja {...} ka qenë pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2017–2019. Për këtë gjyqtare është përgatitur raporti analitik nga nëpunësi përgjegjës i vlerësimit, i cili

është pjesë përbërëse i projektraportit të vlerësimit. Aktet e vlerësimit i janë njoftuar gjyqtares, e cila brenda afatit ka konfirmuar marrjen dijeni dhe ka shprehur edhe vullnetin e saj për të mos pasur kundërshtime, për të mos pasur prova të reja dhe për të mos u paraqitur në seancë dëgjimore në KLGJ.

Në këto kushte, kur projektraporti i vlerësimit, bashkë me aktet e vlerësimit u janë përcjellë të gjithë anëtarëve në rrugë elektronike, po ndalem, duke qenë se raporti është i hollësishëm, thjesht në konkluzionet dhe momentet e rëndësishme për t'i bërë të ditur anëtarëve të Këshillit.

Lidhur me qëllimin e projektraportit të vlerësimit, ai është përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij projektraporti. Ky vlerësim ka për qëllim që të përcaktojë shkallën e aftësisë së gjyqtares për periudhën e vlerësimit 2017–2019. Procedura shpjegohet në mënyrë të detajuar.

Lidhur me analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimin e përcaktimit të nivelit të vlerësimit.

Fillojmë me kriterin e parë të “Aftësive profesionale të gjyqtares”. Duke qenë se projektraportet e vlerësimit shoqërohen nga raportet analitike, unë nuk po ndalem në mënyrë të hollësishme në përshkrimin e burimeve të vlerësimit, në kushtet kur raporti analitik e ka këtë detyrë dhe e bën, po ndalem thjesht në konkluzionet e mia si relatore e kësaj procedure vlerësimi.

Lidhur me “Aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, në tërësi nga analiza e burimeve të vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshëm të fakteve të çështjes, proces të cilin e arrin nëpërmjet analizës së integruar më vete dhe në tërësi të provave sipas një rendi kronologjik të diktuar nga natyra e gjykimit administrativ, pavarësisht pretendimeve të palëve mbi rrethanat e faktit. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktimin e së cilës e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së saj mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Po kështu, rezultojnë aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale

të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktet objekt shqyrtimi.

Për këtë arsye kam vlerësuar se aftësia e gjyqtares lidhur me këtë tregues duhet të vlerësohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Lidhur me “Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, pas studimit të dosjeve, bazuar në raportin analitik, lidhur me interpretimin e ligjit material dhe atë procedural, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuara, apo në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtares për të referuar, zbatuar dhe kur është rasti për të analizuar aspekte të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si një parim i rëndësishëm i gjykimit administrativ, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet burim vlerësimi, ku janë të përmendura edhe në raportin analitik por edhe në projektraportin e vlerësimit, evidentohet edhe praktika gjyqësore relevante unifikuese, ajo e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për këtë arsye kam vlerësuar që lidhur me këtë tregues, aftësia e gjyqtares të vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Lidhur me aspektin e dytë, të “Arsyetimit ligjor”, treguesi “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit, kryesisht të vendimeve gjyqësore, por edhe të akteve procedurale të hartuara nga gjyqtarja, ka rezultuar se ajo i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimit, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej saj për zgjidhje, apo zgjidhjen tërësore të çështjes. Spikat (dhe kjo është e

veçantë tek kjo gjyqtare) konciziteti në paraqitjen e rrethanave të faktit, çka e bën natyrën e konfliktit lehtësisht të kuptueshëm për çdo lexues dhe jo vetëm për njohësit e ligjit.

Për këtë arsye kam vlerësuar që për këtë tregues, aftësia e gjyqtares të vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Lidhur me “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit (kryesisht nga vendimet gjyqësore), rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Kjo mënyrë e standardizuar e të shkruarit të vendimit gjyqësor, orienton lexuesin dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike për atë që është konkluduar prej saj.

Për këtë arsye kam vlerësuar që shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues të vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Lidhur me treguesin e fundit të kriterit të parë që është “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt–normë–interpretim ligjor–konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Për këtë arsye propozohet shkalla e aftësisë “shumë e lartë”, pikëzimi me 25 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e parë, “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, propozohet

niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me "Aftësitë organizative të gjyqtarës", treguesi "Respektimi i afateve ligjore", pas analizës matematikore që ka bërë nëpunësi përgjegjës i vlerësimit ka rezultuar fillimisht që nga 143 çështje me afat ligjore që duhet të shqyrtoheshin brenda periudhës trevjeçare kanë qenë rreth 66% e tyre shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

Gjyqtarja, në formularin e vetëvlerësimit ka dhënë arsyet e veta, sikundër edhe kryetari, për çështjet për të cilat afati ligjor nuk është respektuar. Marrë në konsideratë që një nga pretendimet e ngritura nga gjyqtarja ka qenë "data të ndryshme të hedhjes së shortit me atë kur gjyqtarit i ka kaluar për shqyrtim", pra çështja regjistrohej në një datë të caktuar dhe shorti nuk organizohej brenda të njëjtës ditë por kishte distancë dy ose treditore nga momenti kur çështja hidhej në short dhe i ka kalonte gjyqtarës, çka ndikonte në afatet e shqyrtimit të çështjes. Duke marrë parasysh këtë pretendim, u evidentua nga ana ime si relatores se për 99 çështje e shqyrtuara jashtë afatit, në disa raste vonesa kishte ardhur si pasojë e kalimit të çështjeve me short në një kohë të mëvonshme nga data e regjistrimit, konkretisht: – për 45 (dyzet e pesë) çështje me objekt "Lëshim urdhër ekzekutimi", nëse përllogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes me short, atëherë këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 510 të K.Pr.Civile. Për pasojë këto çështje nuk mund të përfshihen në çështjet e përfunduara jashtë afatit ligjor, duke qenë se kohëzgjatja e tyre ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës; – për 8 (tetë) çështje me objekt "Lëshim urdhër ekzekutimi", vendimi është marrë për një afat prej 6 apo 7 ditësh, duke tejkaluar afatin ligjor me 1 dhe 2 ditë, tejkalim i papërfillshëm që edhe në raste të tjera nuk e kemi konsideruar; – për 5 (pesë) çështje me objekt "Sigurim padie", nëse përllogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes me short, atëherë këto çështje do të kishin përfunduar të gjitha brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 28, pika 3 të ligjit nr.49/2012; – për çështjet me objekt "Kundërshtim veprimesh përmbaremore" (ka qenë 1 çështje), është regjistruar në gjykatë në datën 19.08.2019 dhe i është caktuar gjyqtarës me short në datën 02.09.2019 (pra rreth 14 ditë nga regjistrimi i çështjes), e cila edhe kjo çështje duhet të përjashtohet nga

çështjet me afat ligjor.

Pra nga një rillogaritje matematikore e përqindjes së çështjeve të shqyrtuara tej afateve ligjore, duke zbritur nga totali prej 99 çështje, 59 çështjet e mësipërme të cilat duhet të konsiderohen në afat, pasi tejkalimi i afatit nuk ka ndodhur për shkak të gjyqtarit, rezulton se kjo përqindje është 28% (40 çështje nga 143 çështje të shqyrtuara tej afatit), përqindje e cila sipas metodologjisë përkon me nivelin e vlerësimit prej 9 pikësh.

Në Metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të ulët të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjesh në periudhën e vlerësimit prej 1452 çështjesh, duke përfunduar 1372 prej tyre.

Duke marrë parasysh një analizë logjike të të dhënave statistikore, njëkohësisht duke marrë parasysh ecurinë e gjykimit administrativ për sa i përket çështjeve me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbartimore”, ku qoftë edhe në një respektim korrekt të ligjit, afati 20 ditor nuk do të mundej të respektohej; faktit që për 7 çështje me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbartimore” koha e shqyrtimit ka qenë më e vogël se 45 ditë e parashikuar si kohë shqyrtimi çështjeje për gjykimin në apel; duke marrë parasysh edhe ngarkesën në tërësi të punës së gjyqtarës gjatë afatit 3-vjeçar ku ka përfunduar rreth 1372 çështje, kam vlerësuar që për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë, por jo me nivelin maksimal sepse pavarësisht të gjitha rrethanave duhet të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi për shqyrtimin me përparësi të çështjeve me afat ligjor.

Për këtë arsye kam propozuar që nga 9 pikë, që është thjesht analizë matematikore sipas metodologjisë, të pikëzohet me 12 pikë, por jo me 15 pikë që është niveli maksimal.

Për sa i përket treguesit tjetër që është “Plotësimi i standardeve minimale kohore”,

tashmë Këshilli ka një qëndrim të mbajtur që në përcaktimin e standardit minimal kohor nuk do të respektohet afati 30-ditor por ai 87-ditor i llogaritur si kohë e nevojshme për kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale, duke qenë se ligji për gjykimin administrativ nuk parashikon një afat të posaçëm brenda të cilit çështja duhet të përfundojë në shkallë të parë por ka afate të posaçme për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale, ka rezultuar që nga 1226 çështje të gjykuara për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 163 prej tyre ose 13.26% e çështjeve kanë përfunduar përtej këtij afati.

Duke marrë parasysh analizën matematikore si dhe një analizë logjike të të dhënave e cila bazohet kryesisht në ngarkesën e punës së gjyqtarës por edhe tejkalimit të raportit me 0,3%, kam propozuar që pavarësisht se sipas metodologjisë duhej të vlerësohej me 4 pikë, thjesht bazuar në një analizë matematikore, në një analizë logjike duhet të pikëzohet në një nivel më të lartë pikëzimi, duke e rritur atë me një shkallë, duke u pikëzuar pikërisht me 5 pikë për këtë tregues.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, për të tria kategoritë e çështjeve të gjyqimit administrativ në shkallë të parë, koha ka rezultuar më e shkurtër se afati 87- ditor i pranuar si standard minimal për efekt të krahasimit të kohës mesatare, prandaj për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, në total, për periudhën trevjeçare të vlerësimit janë caktuar 1452 çështje dhe ka përfunduar 1372 çështje. Rendimenti si raport i çështjeve të përfunduara me çështje të caktuara rezulton 94.5%, që sipas metodologjisë pikëzohet me 8 pikë. Edhe për këtë tregues kam propozuar rritjen me një nivel më të lartë vlerësimi sepse ka gjykuar më shumë se 50% të treguesit sasior në fuqi për periudhën 3-vjeçare për çështjet me palë kundërshtare, konkretisht është tejkaluar ky standard me rreth 30% sepse ka rreth 87% të çështjeve të përfunduara pranë saj, që kanë qenë çështje me palë kundërshtare. Është tejkaluar 50% sipas metodologjisë, dhe për këtë tregues propozoj pikëzimin me 10 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsytimit të vendimit”, referuar raportit analitik, për një kategori ka dalë e barabartë me afatin procedural, për dy kategori të tjera ka dalë më e shkurtër se afati procedural, për këtë arsye është pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket treguesit “Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore” dhe “Numri mesatar i seancave për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive”, rezulton se numri mesatar i seancave është 2.1 seanca dhe gjyqtarja në të gjitha rastet ka marrë masa për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Bie në sy që në gjykimin administrativ gjyqtarja organizon në mënyrë perfekte punën për sa i përket procesit paragjyqësor, pra për sa i përket veprimeve paraprake të seancës përgatitore, në mënyrë që kur çështja shkon për gjykim, nga dosjet e analizuara rezulton që seancat janë vetëm dy seanca dhe konkludohet me vendimin përfundimtar. Për këtë arsye kam propozuar që për këtë tregues të vlerësohet me 15 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, gjyqtarja tregon kujdes të veçantë për të gjitha fazat e procesit administrativ në shkallë të parë, që në veprimet procedurale paraprake në seancë përgatitore të cilën e thërret me urdhër dhe njëkohësisht argumenton pse duhet të ketë seancë përgatitore në rastet kur duhet të shtohet ndërgjyqësia, shkaku ligjor i padisë, etj., (përmenden në mënyrë analitike në raportin analitik dhe në projektraportin e vlerësimit); të gjitha vendimet e ndërmjetme për zhvillimin e seancës gjyqësore por edhe vendimet e ndërmjetme në seancë përgatitore janë të arsyetuara me bazën ligjore të tyre; seancat janë të dokumentuara rregullisht me procesverbal gjyqësor i cili mbahet nga ana e gjyqtarës edhe në rastet kur ajo kryen veprime procedurale në dhomë këshillimi; për këtë arsye kam vlerësuar që gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Për këtë arsye kam propozuar një shkallë “shumë të lartë” aftësie me 20 pikë.

Për sa i përket dy treguesve të fundit, “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes”, evidentohet shkallë shumë e lartë aftësie. Aktet janë të renditura në rendin logjik dhe kronologjik sipas kategorisë së tyre. Ndërkohë që nuk evidentohet në dosje mungesa e akteve apo prania e

dokumenteve që nuk i përkasin çështjeve të evidentuara dhe të analizuar. Për dy këta tregues propozohet pikëzim maksimal. 5 pikë për “Rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes” dhe 10 pikë për “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes”.

Përfundimisht, për “Aftësitë organizative” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me 97 pikë.

Për sa i përket kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për sa i përket “Etikës në punë” ka rezultuar që gjatë periudhës së vlerësimit për gjyqtaren nuk janë dhënë dhe as nuk janë zbatuar masa disiplinore. Për sa i përket ankesave të trajtuara në ILD për këtë periudhë rezulton që ka pasur 5 ankesa të trajtuara. Në të gjitha ankesat është vendosur nga ILD-ja arkivimi i tyre duke qenë se ato nuk përmbushin kushtet e pranueshmërisë. Është vlerësuar që në thelb janë ngritur pretendime që lidhen kryesisht me mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe vlerësimit të provave nga ana e gjyqtares. Nuk referohet në asnjë rast elementet që mund të analizohen në drejtim të etikës në punë, qoftë nga përmbajtja e këtyre ankime ashtu edhe nga ILD-ja. Për këtë arsye, në lidhje me etikën nuk ka të dhëna që mund të afektojnë këtë tregues lidhur me trajtimin e ankesave nga ILD-ja.

Ndërkohë që edhe gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës në formularin e integruar të vlerësimit e kanë vlerësuar shumë të lartë aftësinë e gjyqtares në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Për këtë arsye, bazuar në parimin e prezumimit dhe mungesës së të dhënave negative që mund të afektonin këtë tregues, kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie. Pikëzimi me 35 pikë.

Për sa i përket treguesit tjetër “Integriteti”, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, edhe ky tregues në mënyrën e pikëzimit bazohet në parimin e prezumimit që në mungesë të të dhënave që mund të afektonin, do të shkojmë në pikëzim maksimal. Nuk kemi të dhëna që mund të analizohen në drejtim të këtij treguesi; Ndërkohë që edhe raporti i ILDKPI-së ka konstatuar që nuk ka pasur raste të konfliktit të interesit; Ndërkohë që është konstatuar që deklaratimet e saj vjetore janë të sakta dhe të rregullta; Nuk kemi masa disiplinore; Nuk ka ndonjë element që mund të evidentohet nga

burimet e vlerësimit që të evidentohet apo të ketë ndonjë indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenimit dhe nderit të dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që mund të tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e saj. Për këtë arsye është vlerësuar pikëzimi me 40 pikë.

Për sa i përket “Paanësisë së gjyqtares”, “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, nuk ka rezultuar që gjyqtarja në ndonjë rast të ketë përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë dhe prezumohet që gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese. Pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket “Numrit tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”, ka pasur 10 kërkesa për përjashtim, por asnjë prej tyre nuk rezulton që të jetë pranuar. Për këtë arsye vlerësohet i pakonsiderueshëm numri, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket kriterit të fundit që është “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht për “Aftësinë e komunikimit të qartë dhe transparent me trupën gjyqësore dhe me stafin administrativ”, për “Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, si dhe për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë, dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale për ta.

Lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtares në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka rezultuar se gjatë gjithë periudhës trevjeçare të vlerësimit gjyqtarja ka marrë pjesë në 28 aktivitete trajnuese të shtrira në 54.5 ditë trajnimi, si dhe në 3 aktivitete trajnuese ndërkombëtare të shtrira në 14 ditë trajnimi, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15–120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

Për sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për

gjqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, ka pasur të dhëna pasi gjyqtarja është pjesë e mentorëve ose gjyqtarëve udhëheqës për magistratët e vitit të tretë të Shkollës së Magistraturës dhe ka qenë për të gjithë periudhën trevjeçare 2017-2020. Nga ana tjetër ajo ka qenë dhe eksperte dhe lehtësuese në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve. Të dhënat përmenden në projektraport dhe në raport analitik. Për këtë arsye, duke qenë se ka pasur të dhëna, propozimi për pikëzim është për 5 pikë.

Për sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, nuk ka pasur të dhëna për angazhim konkret të gjyqtarës. Gjyqtarja në formularin e vetëvlerësimit ka përmendur që ka marrë pjesë në konferenca, kumtesa, por nuk ka të dhëna dokumentare mbi të cilën të provohen apo që këto konferenca dhe kumtesa t’i përkasin kësaj periudhe vlerësimi 2017-2019. Për këtë arsye, sipas metodologjisë, pikëzimi është 3 pikë.

Për sa përket “Publikimeve ligjore akademike”, nuk ka të dhëna. Propozimi për pikëzim është 0 pikë.

Në total, për kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, niveli i vlerësimit është "Shkëlqyeshëm", pikët 93.

Përfundimisht, për të katër kriteret, propozimi që vjen nga unë si relatore është: “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” – 100, "Shkëlqyeshëm"; “Aftësitë organizative të gjyqtarës” – 97, "Shkëlqyeshëm"; “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” – 100, "Shkëlqyeshëm"; “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” – 93, "Shkëlqyeshëm". Në total pikëzimi 390 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Janë përpiluar në përfundim të projektraportit të vlerësimit edhe propozimet dhe rekomandimet konkrete që kryesisht konsistojnë në mbajtjen në konsideratë nga ana e gjyqtarës për t’u angazhuar në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime nga anëtarët prezent në mbledhje për çka u parashtrua nga relatorja?
Atëherë, kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017–2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017–2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të

internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.02.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Greta D, Vladimir Karaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Ilir Rusi: Sipas rendit të ditës vazhdojmë me pikën tre të tij, shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej relatore zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Relacioni është i detajuar. Unë do përpiqem ta relatoj në mënyrë të përmbledhur.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, tashmë ka filluar dhe vazhdon të angazhohet në trajtimin me përparësi të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar apo atë që ne e quajmë gradim të gjyqtarëve, në zbatim të nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin. Në këtë kuadër ka ardhur edhe dosja e vlerësimit e gjyqtarës {...}, së bashku me aktet e vlerësimit profesional, si dhe vendimi nr. 593, datë 25.11.2022 të KPK-së, i cili rezulton që të ketë marrë formë të prerë për shkak mosankimimi.

Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të dosjes të përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtarës, ka rezultuar se zonja {...}, në periudhën tetor 2012 – shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2014 deri në muajin gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë që, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me dekretin nr. 9656, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës.

Sa më sipër, nga një verifikim paraprak, ka rezultuar se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, znj. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në periudhën e praktikës profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës për një kohëzgjatje prej 11 muajsh. Ndërsa funksionin e gjyqtarës, pas emërimit në datën 23.06.2016 e në vazhdim, deri në përfundim të periudhës së vlerësimit që është tetor 2016, apo edhe në qoftë se e marrim 31 dhjetor 2016, rezulton se gjyqtarja nuk e ka ushtruar asnjë ditë për shkak se po në muajin qershor të vitit 2016, gjyqtarja është shkëputur me leje barrë lindje dhe është rikthyer në punë ose ka filluar punën tashmë pas dekretit, në datë 26.05.2017.

Në vijim, nuk po ndalem në citimin e ligjit, sepse janë të gjitha dispozitat ligjore në relacion që gjejnë zbatim.

Gradimi i gjyqtarëve sipas nenit 171, pika 5 është përparësi për Këshillin, sipas dispozitës ligjore, i cili e fillon gradimin për aq sa është e mundur në zbatim të këtij ligji dhe ligjeve të tjera.

Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas

Ligjit “Për Statusin”, vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur. Me termin “Ligj” do të kuptohet jo vetëm ligji “Për statusin”, por edhe Ligjet e tjera që afektojnë për shkak kompetence të organit, gradimin e gjyqtarëve, sikundër ka qenë Ligji nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili për periudhën tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, përcaktonte si organ kompetent Shkollën e Magjistraturës, për të bërë vlerësim etik dhe profesional për gjyqtarët në vitin e tretë të programit të formimit fillestar.

Që të mos ndalem më tej në relacion, Këshilli ka tashmë një qëndrim të mbajtur lidhur me moskonsiderimin e periudhës së stazhit profesional aktiv për magjistratët e vitit të tretë të shkollës, për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, sepse ajo ka qenë pjesë e vlerësimit të shkollës, me të cilën është bërë renditja, pikëzimi, mbi bazën e të cilave është bërë edhe emërimi më tej i gjyqtarëve.

Ndërkohë, përveç periudhës së stazhit profesional, gjyqtarja nuk ka asnjë ditë pune si gjyqtare, kohë punë aktive të themi, mbas përfundimit të stazhit, në qoftë se e marrim deri në 31 dhjetor 2016, që është periudha e rivlerësimit kalimtar, ne e marrim periudhë të plotë vlerësimi, pavarësisht se periudha e rivlerësimit kalimtar është në tetor 2016.

Në nenin 41 të Kodit të Procedurës Administrative që rregullon rastet dhe mënyrën e fillimit të një procedimi administrativ, në lidhje me nenin 171 pika 5 të Ligjit “Për Statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- 1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.
- 2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;
- 3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Dua të theksoj këtu një qëndrim të mbajtur nga Gjykata e Apelit Administrativ. Ç'bënim ne deri më sot? Ne si Komision, në momentin që vinin dosjet me aktet e

vlerësimit profesional për secilin nga gjyqtarët e konfirmuar me vendim të formës së prerë, sillnim aktin në plenare pa bërë një verifikim paraprak apo të dukshëm të kushteve për fillimin apo mosfillimin e procedurës së vlerësimit dhe pasi fillonte kjo procedurë dhe ndaheshin relatorët, në eventualitetin kur gjyqtarët kishin më pas se një vit punë, ne vinim me propozimin për përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar. Ndërkohë, për shkak të një konflikti që është bërë në gjykimin e apelit administrativ, Gjykata e Apelit Administrativ ka orientuar Këshillin që të tregohet i kujdesshëm që të mos fillojë një procedurë në rastet kur mungesa e kushteve ka qenë evidente që në momentin e fillimit të procedurës. Për këtë arsye është parashikuar (në relacion gjeni edhe orientimet që Gjykata e Apelit Administrativ ka bërë për Këshillin e Lartë Gjyqësor) që për çdo dosje që na vjen nga organet e rivlerësimit atëherë kur shkaqet e mosfillimit janë të dukshme siç janë për shembull rastet kur gjyqtari ka qenë gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit si kandidat për gjyqtar apo ka ndjekur vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës apo në rastin kur ai nuk ka një vit pune të plotë, t'ia përcjellim mbledhjes plenare për të vendosur ajo mosfillimin e procedurës së vlerësimit në kushtet kur është kompetencë e Këshillit për të vendosur gjithçka që lidhet me vlerësimin e gjyqtarëve.

Për këtë arsye, në pikën e parë të projektvendimit parashikohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit për gjyqtaren {...}, pasi së pari nuk plotësohen kushtet për fillimin e kësaj procedure, në kushtet kur gjyqtarja, veç stazhit profesional, periudhë e cila ka qenë objekt i vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës, nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarit asnjë ditë tjetër gjatë kësaj periudhës së vlerësimit.

Në pikën e dytë të projektvendimit parashikohet që një kopje e vendimit për mosfillimin e procedurës t'i njoftohet gjyqtares.

Njëkohësisht parashikohet e drejta e ankimit duke qenë se jemi para një akti individual të Këshillit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime për çfarë u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.02.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa). (shtyrë nga mbledhja plenare datë 27.01.2023).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Greta D, Vladimir Karaj (BIRN).*
8. *{...}, magjistrat.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Yllka Rupa*). (shtyrë nga mbledhja plenare datë 27.01.2023).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”, për të cilin është

përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me relatore zonjën Yllka Rupa.

Ritheksoj faktin që kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë nga mbledhja plenare e datës 27.01.2023, për faktin, sepse zoti {...} ka shprehur dëshirën për të qenë prezent në shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës. Meqenëse kishte arsye objektive për të cilat u shty seanca, sot me njoftimin nga administrata ai është prezent, dhe të ftohet zoti {...} të jetë pjesë e relacionit dhe pastaj diskutimeve nëse ka.

(Hyn në sallën e mbledhjes zoti {...}.)

Ilir Rusi: Përshëndetje zoti {...} !

Sipas kërkesës tuaj, keni bërë kërkesë për të qenë prezent në shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, e cila ka të bëjë po me ju.

Në vijim fjala është për relatoren, zonjën Rupa dhe më tej, pastaj, fjala është për ju dhe anëtarët e tjerë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas rastit.

Po, zonja Rupa!

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

I nderuar zoti {...} !

Në cilësinë e relatores do të paraqes relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, lidhur me përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, me vendimin nr. 239, datë 30.06.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me

qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit është edhe z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Nëpërmjet këtij vendimi, bazuar në procedurën e shortit, për vlerësimin e gjyqtarit {...} për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, është përzgjedhur raportore znj. Yllka Rupa dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Në datë 30.06.2022, bazuar në nenin 85 dhe 89 të ligjit “Për statusin”, i është njoftuar gjyqtarit vendimi për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional si dhe emrat e vlerësuesve, nëpërmjet postës elektronike. Në datë 04.07.2022 gjyqtari ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka deklaruar se është dakord me vlerësuesit.

Nëpunësja përgjegjëse për vlerësimin, bazuar në parashikimet e nenit 24, të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020 “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, ka hartuar procesverbalin për pasqyrimin e çështjeve dhe vendimeve që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit.

Në vijim të procedurës së vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtarit, ka rezultuar:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. {...}, datë 24.07.2020 pasi ka parashtruar dhe analizuar të gjitha burimet e vlerësimit në lidhje me aftësitë profesionale të gjyqtarit, ka konkluduar lidhur me këtë kriter vlerësimi: “Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmon se subjekti ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij, si vijon: – në 4 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta në gjykimin e çështjes; – në 2 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka qenë efektiv pasi ka zvarritur procesin. Komisioni konkludon se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të thellohej në arsyetimin e vendimeve, të kontrollonte lidhjen logjike të argumentimeve si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji procedural penal dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij”.

Për këto arsye Trupa Gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka vendosur:

1. Pezullimin nga detyra të z. {...} për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar mbi të tri kriteret e vlerësimit.

Pas administrimit të rezultateve të provimit përfundimtar të subjekti të rivlerësimit në mbarim të programit të trajnimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ka konkluduar: “2. Subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe 3. subjekti, bazuar në shkresën e Shkollës së Magjistraturës, rezulton se ka përfunduar me sukses programin e trajnimit, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara nga Komisioni”.

Neni “Ë” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Komisioni ose Kolegji i Apelit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Në çdo rast vendimi jepet i arsyetuar. 2. Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë”.

Neni 58 i ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me masat disiplinore parashikon se: “1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: a) konfirmimin në detyrë; b) pezullim nga detyra për një periudhë 1–vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës; c) shkarkimin nga detyra”. Ndërsa në nenin 60 parashikohet se: “1. Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1–vjeçare i jepet subjektit të rivlerësimit nëse janë evidentuar mangësi në aftësitë e tij profesionale që mund të plotësohen...”.

Në nenin 45/1, të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, lidhur me vlerësimin për magjistratët të cilët do të ndjekin për një vit Programin e Formimit

Fillestar, bazuar në vendimin e institucioneve të rivlerësimit përcaktohet se: “Në kuptim të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, subjektet e rivlerësimit të cilët janë pezulluar nga detyra dhe kanë detyrimin të ndjekin programin njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të vitit të parë akademik vlerësohen nga rezultatet e provimit përfundimtar, [...]”

Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën vlerësimit 2013-2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të ligjit “Për statusin”, i cili parashikon: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës”. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, në kushtet kur rezultoi se për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi, në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të ligjit “Për statusin”, gjyqtarit {...} i është dhënë masa disiplinore e pezullimit nga detyra për një vit dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhe 1–vjeçare për shkak të evidentimit të mangësive në aftësitë e tij profesionale, procedura e vlerësimit etik dhe profesional të filluar për periudhën 3–vjeçare që përfshin vitet 2013 – 2016, nuk mund të vazhdojë.

Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, është vlerësuar nga organet e rivlerësimit

kalimtar me mangësi, procedura e vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), nuk mund të vazhdojë, pasi gjyqtari nuk ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale për periudhën e vlerësimit.

Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli zbaton Kodin e Procedurave Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Në rastin konkret, për z. {...}, shkak për të cilin ka filluar me prioritet procedura e vlerësimit etik dhe profesional sipas parashikimeve të cituara më lart, rezulton të jetë objektivisht i pamundur dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i këtij procesi nuk ekziston. Për pasojë vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...} për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, nuk mund të vazhdojë.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi përfundimtar pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për shkak se vijimi i saj rezulton i pamundur pasi gjyqtari nuk ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për përfundimin e procedurës së vlerësimit t’i njoftohet gjyqtarit {...}.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht

menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Për më tej fjala për ju zoti {...} .

{...}: Faleminderit!

Unë jam njohur me këtë relacion ardhur nga relatorja zonja Yllka Rupa. Mendoj që i gjithë thelbi i këtij projektvendimi konsiston në referimin që i bëhet vendimit nr. 5, datë 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është një vendim i ndërmjetëm (nuk është vendim përfundimtar), ku nga ana e këtij komisioni unë jam pezulluar nga detyra, dhe më është dhënë detyrimi për të ndjekur programet e trajnimit pas kurikalave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, detyrim i cili është përmbushur nga ana ime, në përfundim jam vlerësuar mirë. Në përfundim të këtij rivlerësimi përfundimtar, unë si subjekt rivlerësimi, me vendimin nr. 444 jam konfirmuar në detyrë.

Vendimi nr. 5, ka çmuar se subjekti (pra unë gjyqtar {...}) ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij si vijon: – në 4 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar njohuri të cekëta; – në 2 raste, nuk ka qenë efektiv pasi ka zvarritur procesin.

Dua t’i bëj me dije këtij Këshilli se të katër rastet që evidentohen nga ky komision në vendimin nr. 5, nuk i përkasin periudhës 2013 – 2016. Të gjitha këto raste janë para kësaj periudhe, pasi komisioni i ka hyrë që nga viti 2005, 2006, 2007 e me radhë.

Di që unë jam hera e tretë që vij para një Këshilli, dy herë ish–KLD–ja dhe kësaj radhe te Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në dy rastet e mëparshme unë jam vlerësuar “Shumë mirë” me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pra këto katër raste nuk i referohen vendimeve të periudhës 2013 – 2016.

Gjithashtu më poshtë thuhet se në 2 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka qenë efektiv pasi ka zvarritur procesin. Dua t’ju bëj me dije se në këto dy raste unë nuk kam qenë kryesuesi i trupit gjykues, relatori i çështjes, kam qenë anëtar i trupit

gjkues, të cilën ia kam bërë të ditur edhe komisionit. Megjithatë, ai ka qenë një vendim i tij i paankimueshëm, pra vendim i ndërmjetëm, siç e parashikon edhe Kushtetuta në aneksin e saj. Në fund unë jam rivlerësuar me të tre elementët (pastërtisë së figurës, etike dhe profesionale si dhe pasurisë) dhe nuk e shikoj se është i pamundur.

Po ashtu, duke iu referuar nenit 77 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”, “Burimet e vlerësimit”: Vlerësimi i magjistratit bazohet në këto burime (janë me radhë nga germa “a” deri tek germa “gj”) dhe në asnjë rast nuk thuhet që si burim vlerësimi janë edhe vendimet e ndërmjetme të KPK-së, nuk janë pjesë e burimit të vlerësimit, sipas meje.

Kështu unë nuk shoh ndonjë pamundësi, pasi statistikat janë, vlerësimet e mia të mëparshme janë, dosjet janë aty, vendimet, i gjithë aktiviteti im është i mundur për t’u vlerësuar. Kështu që e vlerësoj si të mundur këtë gjë.

Kaq! S’kam çfarë them tjetër?

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...} !

{...}: Faleminderit juve!

Ilir Rusi: Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse kanë pyetje për t’i adresuar magjistratit.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Përshëndetje zoti {...} !

Në cilësinë e gjyqtarit ju mund të na thoni, si e vlerësoni fuqinë juridike të vendimit të ndërmjetëm të KPK – së, në kushtet kur ai është i paankimueshëm? Pra çfarë vlere ka ky për Këshillin? Duke ju cituar edhe një herë faktin që vërtet nuk përmendet në ligj që vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përbëjnë burime vlerësimi për efekt të vlerësimit të gjyqtarit, por mos harroni që ky vendim është një vendim që cakton një masë disiplinore për gjyqtarin dhe vendimet për masat disiplinore për gjyqtarin, përbëjnë burime vlerësimi. Sipas jush, çfarë vlere duhet t’i japim në këtë vendim?

{...}: Unë e kuptoj që duke qenë një vendim i paankimueshëm, normalisht, në kuadrin e vendimit të formës së prerë dhe nuk mund të konsiderohet si diçka e pa... (*e ndërpret mendimin*). Por unë thashë, në qoftë se relatorja (sipas meje) do t'i hynte vendimit, se unë nuk e kam, nuk më është vënë në dispozicion ky vendimi nr. 5 (nuk më është vënë në dispozicion), është marrë vendimi nga KPK-ja, kam shkuar në magistraturë. Por kur i kam hyrë projektit të rivlerësimit tim, shihet që rastet që ato i konsiderojnë si të meta, janë jo të periudhës 2013 – 2016, pra nuk janë vendime të kësaj periudhe. Prandaj po them unë. Për ato vendime që ajo KPK i vlerëson dhe i ka quajtur të cekëta, më janë vlerësuar nga ish-KLD-ja. Janë vendime një të 2005, një të 2007, një të 2009. Nuk është se janë të një periudhe. Për këtë periudhë ky gjyqtar ka disa vendime dhe... (*e ndërpret mendimin*). Janë vendime të marra që nga 2003, 2004, e me radhë.

Brikena Ukperaj: Pra ju thoni që për këto vendime që janë marrë në 2004, në fakt janë marrë nga janari 2006, se që aty mund ta shtrijë KPK-ja.

{...}: Unë jam vlerësuar.

Brikena Ukperaj: Ti je vlerësuar shumë mirë nga KLD-ja.

Faleminderit!

{...}: Faleminderit ju!

Ilir Rusi: Ka pyetje nga anëtarët e tjerë?

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Përshëndetje!

Në mendimin tuaj zoti gjyqtar, a mundet Këshilli i Lartë Gjyqësor të bëjë një rivlerësim të një vendimi që e ka marrë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe që është i

formës së prerë? Sepse pjesë e atij vendimi është edhe analiza e aftësive profesionale. Apo jo? Nëse ju vini sot këtu dhe i thoni Këshillit: – “Duhet të bëni vlerësimin tim profesional”, – mendoni që Këshilli sot ka kompetencën të dali përtej atij vendimi?

Ilir Rusi: Po zoti {...} , fjala për ju!

{...}: Këshilli i Lartë Gjyqësor, ashtu si KPK-ja janë institucione kushtetuese dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre të pavarur pavarësisht se marrin indicie, marrin ndikim edhe nga vendimet respektive. Edhe KPK-ja ka marrë dosjen time në rivlerësim nga KLGJ-ja, që e ka bërë pjesë në vlerësimin e saj, po ashtu edhe KLGJ-ja nuk thashë që duhet ta injorojë vendimin e KPK-së për këtë vendim të ndërmjetëm, por ama thashë që duke iu referuar vetë përmbajtjes së këtij vendimi të ndërmjetëm çështjet që trajtohen në këtë vendim nuk janë të kësaj periudhe vlerësimi. Këtu e shikoj unë atë kontradiktën. Si mund të vlerësohem nga një institucion i pavarur, që ka qenë KLGJ-ja në atë kohë (më fal, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sot KLGJ-ja), të vlerësohem “Shumë mirë”, nga një institucion po i pavarur që është KPK-ja, për dy-tre çështje, për dy masa sigurimi bëhet e gjithë çështja, që të jem i sinqertë, për dy masa sigurimi. Nuk e di a ka gjyqtarë në Republikën e Shqipërisë që nuk i është prishur një masë sigurimi. Mund të ketë, por nuk po them që nuk ka. Vendimet e masave nuk janë vendime themeli. Por për këto dy çështje... dhe është gjetur kjo klauzolë juridike ligjore.

Nuk e di a mund të thellohem më tepër. Në qoftë se kjo përbën pengesë, dakord. Unë kam besimplotë tek ky Këshill që do ta vlerësojë, do ta shikojë dhe fundja e fundit le të vlerësojë. Thjesht doja të bëja ato sqarimet e mia se ndihem paksa kontradiktor në këtë mënyrë se si është marrë vendimi.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...} !

Por sa për sqarim, nuk është marrë ende vendim. Ai është relativ.

Gjithsesi, ka pyetje të tjera nga anëtarët?

(Nuk ka pyetje nga anëtarët.)

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...} !

Javë të mbarë!

Në vijim Këshilli do të vazhdojë me procedurat përkatëse.

(Largohet nga salla e mbledhjes z. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim, ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime apo jo.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Atëherë, pasi dëgjuam edhe shpjegimet e gjyqtarit, doja të theksoja që për sa i përket procesit të gradimit, Këshilli bazohet në aktet që vijnë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Procedura e përcaktimit të nivelit të vlerësimit të gjyqtarit apo gradimi mund të bëhet vetëm për gjyqtarët që arrijnë nivelin minimal profesional. Nëse gjyqtari në vendim të Komisioni të Pavarur të Kualifikimit nuk e arrin nivelin minimal profesional për periudhën 2013–2016 e cila mund të shtrihet që nga janari 2006 sipas ligjit, Këshilli nuk mund të bëj dot gradim. Nga ana tjetër, Këshilli nuk mund të vërë dot në diskutim as konkluzionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i cili ka konstatuar se gjyqtari për këtë periudhë nuk arrin nivelin minimal profesional, prandaj duhet t'i nënshtrohet programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës si një masë disiplinore e parashikuar në ligj. Për këtë arsye ne nuk kemi mundësi për të bërë gradimin e gjyqtarit.

Ndodh vërtet që të gjitha dosjet dhe vendimet e gjyqtarëve, të dhëna gjatë periudhës së rivlerësimit, t'i rikonsiderojë Këshilli, por këto i rikonsideron vetëm për gjyqtarët që KPK-ja me vendim të formës së prerë ka konkluduar që arrin nivelin minimal profesional. Pra nëse gjyqtari arrin nivelin minimal profesional, ne kur përcaktojmë gradimin, si burime vlerësimi marrim të gjitha dosjet që kanë vlerësuar organet e rivlerësimit, komisioni i pavarur, i cili e shikon vetëm në aspektin nëse e arrin

nivelin minimal/nuk e arrin nivelin minimal. Ndërsa ne e shohim në aspekt më të thelluar: Cila është grada që merr gjyqtari mbi këtë nivel minimal? Është "Shkëlqyeshëm", është "Shumë mirë", është "Mirë" apo është "Mjaftueshëm". Por edhe ne, në çdo raport vlerësimi themi që Këshilli ka një pushtet të pavarur në përcaktimin e gradës së gjyqtarit, pavarësisht konkluzionit që nxjerr KPK-ja, por ama vetëm për gjyqtarët që arrijnë nivelin minimal kualifikues. Nëse gjyqtari nuk e arrin nivelin minimal kualifikues, ky gradim nuk mund të bëhet. Nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kompetenca kushtetuese për të përcaktuar nëse e ke nivelin minimal apo nuk e ke, është e paankimueshme. Po ta shohim, këto vendime janë vendime vërtet të ndërmjetme por janë vendime të formës së prerë që nuk mund të rivihen më në diskutim.

Për këtë arsye unë i qëndroj propozimit që bëri relatorja, i cili i është nënshtruar edhe diskutimit në Komision, për përfundimin e procedurës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, pas fjalës së zotit {...} , pyetjeve, diskutimeve, ftoj relatoren për qëndrimin e saj përfundimtar në rastin në fjalë.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim projektvendimin përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për shkak se vijimi i saj rezulton i pamundur pasi gjyqtari nuk ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale për periudhën e vlerësimit.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.02.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

10. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Greta D, Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Në vijim, vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës, shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej, fjalën relatore Yllka Rupa. Gjithashtu edhe zonja {...} është bërë me dije mbi këtë rend dite.

Po, zonja Rupa!

Yllka Rupa: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka si detyrë të fillojë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët që kanë kaluar me sukses këtë proces është edhe znj. {...} , gjyqtare në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht e komanduar si ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Lartë.

Trupa Gjykues e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...} ka plotësuar tre kushtet e kualifikimit, duke arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, në kontrollin e figurës dhe në vlerësimin e aftësive profesionale. Në këto kushte ka vendosur:

“1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...} , gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.”

Neni 171/5 i ligjit nr.86/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikon se: “Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të dosjes së rivlerësimit kalimtar për znj. {...} , rezulton se gjyqtarja të ketë ndjekur Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës përgjatë periudhës tetor 2012 – shtator 2015.

Me Dekretin nr.8768, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, znj. {...} rezulton të jetë caktuar përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në periudhën tetor 2014 – gusht 2015.

Me Dekretin nr.9655, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë znj. {...} rezulton të jetë emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Gjyqtarja {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për periudhën 23.06.2016 – 8.10.2016, (gjithsej 3 muaj e 15 ditë).

Me Vendim nr. 4, datë 18.01.2018 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo është komanduar ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë me një afat 5–vjeçar.

Gjithashtu me vendimin nr. 33, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...} është konfirmuar ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Lartë, duke iu përsëritur komandimi me 3 (tre) vite të tjera.

Situata faktike e zhvillimit të karrierës së gjyqtares, ballafaquar me kuadrin ligjor që mundëson vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale për periudhën objekt vlerësimi, 2013 – 2016, rezulton të jetë e pamjaftueshme për të mundësuar përcaktimin e nivelit të vlerësimit etik dhe profesional, (gradimin) e gjyqtares.

Referuar praktikës së mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, periudha e cila përkon me kohën kur gjyqtarja ka kryer stazhin profesional, tetori 2014 deri në muajin gusht 2015, nuk përbën objekt vlerësimi.

Për sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në ligjin e kohës nr.8136, datë 31.07.1996 “ Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 parashikohet se:

“ Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

- a) një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;
- b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë;
- c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori (periudha e stazhit profesional).

Periudha e stazhit profesional, konsiderohej nga ligji i kohës si pjesë integrale e programit të formimit fillestar të magjistratit dhe si e tillë ishte pjesë e kuadrit vlerësues që bënte Shkolla e Magjistraturës.

Gjyqtarja {...} është vlerësuar për periudhën e stazhit profesional nga Shkolla e Magjistraturës.

Shkalla e vlerësimit të kryer në kuadër të stazhit profesional është konsideruar, krahas kritereve të tjera ligjore, për kualifikimin dhe renditjen e kandidatës për efekt të njohjes së titulli “magjistrat”, emërimit dhe caktimit të saj në detyrë.

Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke qenë së ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit, është një mekanizëm kontrolli në funksion të cilësisë dhe efektivitetit në ushtrim të detyrës. Duke qenë i tillë mbështetet në një procedurë rigoroze ligjore, bazuar në burime vlerësimi të plota të cilat përbëjnë bazën e të dhënave ku mbështetet vendimmarrja në lidhje me nivelin e pikëzimit dhe atë të vlerësimit të gjyqtarit. Për këtë qëllim ligji ka parashikuar edhe kushtet që lejojnë kryerjen në mënyrë efektive të kësaj procedure.

Në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, për sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, parashikohet:

“1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar.

2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat...”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar rregulla plotësuese për vlerësimin e gjyqtarëve duke përcaktuar ndër të tjera domosdoshmërinë e ekzistencës së një periudhe minimale (jo më pak se një vit) e cila mundëson një vlerësim objektiv bazuar në burime vlerësimi të mjaftueshme.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 “ Rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 5, parashikohet se:

1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin...

2. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

3. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçar, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit’.

Në zbatim të nenit 41 të Kotit të Procedurave Administrative në lidhje me nenin 171, pika 5, të ligjit “Për Statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit duke u konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;

Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;

Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr.86, datë 07.12.2022, vendim i cili ka rrëzuar padinë e një gjyqtari, duke pranuar arsyetimin e Këshillit për pamundësinë në objekt e qëllim të procedurës së gradimit të filluar për këtë gjyqtar, ka arsyetuar: “[...] kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar/vetting për gjyqtarin, përbënte rrethanë të pamjaftueshme për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional/vlerësimit periodik, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit/gradimin, për sa kohë që nuk plotësohej edhe një tjetër kusht, ai i përvojës së punës/kohës së ushtrimit të detyrës si gjyqtar, jo më pak se një vit”. Gjykata e Apelit Administrativ konfirmon qëndrimin e Këshillit se kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar nga një gjyqtar, nuk e bën të pazbatueshme pengesën e parashikuar në nenin 5/4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në rastin konkret, me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve ligjore për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional sipas parashikimeve të mësipërme për gjyqtaren { ... } , Këshilli duhet të vendosë mosfillimin e procedurës së

vlerësimin etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimin (gradimin), të gjyqtarës {...} .

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet mosfillimi i procedurës së vlerësimin etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimin (gradimin), të gjyqtarës {...} , për periudhën e vlerësimin 2013 – 2016.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për mosfillimin e procedurës së vlerësimin të përshpejtuar të detyruar t'i njoftohet gjyqtarës {...} , sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime.

(Nuk kanë diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimin etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimin (gradimin), për periudhën e vlerësimin 2013 – 2016, për gjyqtarën {...} ”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...} , për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...} , sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.02.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

10. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Greta D, Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës, shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej ia jap fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, shkurtimisht do të parashtoj edhe unë relacionin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e gradimit, për gjyqtarin {...}.

Ky i fundit është njoftuar paraprakisht lidhur me relacionin. Nëpërmjet e-mail-it të datës 08.02.2023 ka konfirmuar marrjen dijeni, duke deklaruar se nuk ka kundërshtime dhe nuk do të ushtrojë as të drejtën e ankimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit “Për statusin”, ka detyrimin që të fillojë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për të gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit kalimtar.

Në Këshill është paraqitur dosja nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për gjyqtarin {...}, si dhe vendimi përfundimtar me nr.{...}96, datë 09.12.2022 që ka vendosur konfirmimin e tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar, ka rezultuar se z.{...} në periudhën tetor 2013 – korrik 2016 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga muaji nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr.{...}, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ai është caktuar të ushtrojë funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Sa më sipër rezulton se, për periudhën 2013 – 2016, z. Jahollari ka ushtruar detyrën e gjyqtarit vetëm për periudhën e stazhit profesional për një periudhë 8 muaj e 11 ditë, konkretisht nga muaji nëntor 2015 dhe deri në muajin korrik 2016. Ndërsa ai është caktuar për të ushtruar funksionin e gjyqtarit vetëm në datën 10.02.2017 (periudhë e cila është jashtë periudhës së vlerësimit 2013 – 2016).

Për vlerësimin e tij gjatë Shkollës së Magjistraturës e cila përkon edhe me vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, vlerësimi bëhet sipas ligjit me nr.8136, “Për Shkollën e Magjistraturës”, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur gjyqtari ka kryer stazhin profesional.

Referuar kuadrit ligjor, rezulton se periudha e stazhit profesional përkon me vitin e tretë dhe vlerësimi i tij bëhet nga Shkolla e Magjistraturës në bazë të pikëzimit, më pas bëhet renditja dhe caktimi i tij në detyrë.

Dispozitat e mësipërme, konkretisht neni 171 i ligjit “Për statusin” detyron Këshillin e Lartë Gjyqësor për aq sa është i mundur që të bëhet vlerësimi me qëllim përcaktimin e gradës së vlerësimit për të cilët kalojnë me sukses procedurën e vlerësimit.

Me “Ligj” do të kuptohet jo vetëm ligji “Për statusin”, por edhe ligjet e tjera që afektojnë organin kompetent, konkretisht ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”. Në rastin konkret, duke qenë se për periudhën nëntor 2015 deri në muajin korrik 2016, gjyqtari ka kryer stazhin profesional, që përkon me vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, Shkolla e Magjistraturës ka bërë vlerësim etik dhe profesional të tij, në bazë të të cilit më pas është bërë renditja dhe emërimi i tij nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Siç u relatua më sipër, për periudhën 2013 – 2016 gjyqtari nuk është caktuar dhe nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit.

Ligji “Për statusin”, konkretisht neni 84, si dhe rregullorja nr. 263/2019, përcakton se periudha e vlerësimit është trevjeçare dhe duhet të ketë së paku një vit përvojë pune.

Në zbatim të nenit 41 të Kodit të Procedurës Administrative, në lidhje me nenin 171 të ligjit “Për Statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte, konkretisht:

- 1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit;
- 2) Periudha e stazhit profesional të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;
- 3) Koha/periudha e punës si gjyqtar të jetë jo më pak se një vit.

Në rastin konkret, me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve ligjore për fillimin e procedurës së rivlerësimit sipas nenit 171/5 për gjyqtarin {...}, Këshilli duhet të vendosë mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e gradimit.

Siç u theksua edhe më sipër, më parë Këshilli vendoste përfundimin e procedurës së vlerësimit pasi më parë kishte hedhur në short përcaktimin e relatorit, por në zbatim edhe të vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, konkretisht me nr. 84, datë 07.12.2022, e cila ka shqyrtuar një ndër vendimet për përfundimin e procedurës së

vlerësimit, Komisioni vlerësoi që të vendoste mosfillimin e procedurës së vlerësimit 2013 – 2016.

Sa më sipër, në pikën 1 të projektvendimit propozohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtarin {...}, për periudhën 2013 – 2016.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit t'i njoftohet gjyqtarit, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016.

Në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit të këtij vendimi.

Në fund përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ftoj anëtarët për diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.02.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim sipas Skemës së Re të Vlerësimit, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 13:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Greta D, Vladimir Karaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim sipas Skemës së Re të Vlerësimit, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës, shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime sipas Skemës së Re të Vlerësimit, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me

vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjala për relatore, znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, datë 18.01.2023 ka hapur 10 (dhjetë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 10 (dhjetë) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile.

Gjithashtu Këshilli, me vendimet nr. 21, 22, 23 dhe 24, datë 18.01.2023 ka hapur 4 (katër) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për 4 (katër) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për secilin nga pozicionet e mësipërme, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, njëkohësisht edhe njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezultojnë të kenë kandiduar gjyqtarët sipas tabelës së mëposhtme:

Për vendimin nr. 11 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e komanduar ndihmësmagjistrate në Gjykatë e Lartë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin) dhe {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë).

Për vendimin nr. 12 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e komanduar në Gjykatën e Lartë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 13, rezultojnë të kenë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Berat), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e komanduar në Gjykatë e Lartë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 14 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë) dhe {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 15 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e transferuar në Krujë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, i transferuar në Gjirokastër), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë) dhe {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 16 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 17 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), {...} (lapsus, pasi behet fjalë për zoti Jahollari) (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec), më falni, {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër).

Për vendimin nr. 18 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës), Artur Prenda (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e komanduar në Gjykatën e Lartë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), Adelajda Gjuzi (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 19 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e transferuar në Krujë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, e transferuar në Kavajë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), {...}

(Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, i transferuar në Gjirokastrë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e komanduar në Gjykatën e Lartë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier).

Për pozicionin e fundit të shpallur për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin me nr. 20, kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e komanduar në Gjykatën e Lartë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier) dhe {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër).

Për katër pozicionet e shpallura për lëvizje paralele në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kanë kandiduar gjyqtarët, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 21, kanë kandiduar: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e transferuar në Krujë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 22: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, i transferuar në Kavajë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 23 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin) dhe {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër).

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 24 kanë kandiduar gjyqtarët: {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, i transferuar në Gjirokastrë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, i transferuar në Kavajë), {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin).

Në zbatim të nenit 43 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 320, datë 17.09.2020 “ Për

kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, për çdo pozicion të lirë të shpallur, fillon për gjyqtarët kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike profesionale. Në rast se për pozicionin konkret nuk ka kandidatë të tillë, ata janë tërhequr nga kandidimi ose janë skualifikuar për mosplotësim kushtesh, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim, e në mungesë edhe të këtyre të fundit, vijon me kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim. Për të bërë të mundur në veçanti evidentimin e gjyqtarëve që “mund të kenë 2 vlerësime, mund të kenë 1 vlerësim, ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, në pikën 9 të çdo vendimi hapje procedure lëvizje paralele, Këshilli ka parashikuar se: “Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi verifikoi përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë si më sipër dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, referuar skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve, vlerësime të mbaruara, atyre në proces të filluara ose që mund të fillonin sipas programit të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, si dhe bazuar në detyrimin e parashikuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263, datë 21.11.2019 për fillimin e procedurës së vlerësimit të përsheptuar të detyruar për gjyqtarët që kanë aplikuar në rastin konkret për lëvizje paralele, vlerëson se (këto janë edhe disa standarde që ne kemi mbajtur parasysh në përcaktimin e listave të gjyqtarëve):

- Mundësia e pasjes së dy apo të një vlerësimi, evidentohet referuar programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, pjesë e të cilëve janë: gradimet; vlerësimet periodike 3-vjeçare si dhe vlerësimet e përsheptuara në rastet kur gjyqtarët kandidojnë për lëvizje paralele. Hapja e procedurave për lëvizje paralele nuk nënkupton dhe as kërkon sipas ligjit miratimin e programeve të posaçme të vlerësimit për të gjithë gjyqtarët kandidatë;

- Referuar neneve 43, 84 dhe 171 të ligjit “Për statusin”, si dhe vendimit nr.320, datë 17.09.2020, për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më shumë se 1 vit pune si gjyqtar (duke përjashtuar stazhin profesional të kryer në kuadër të Shkollës së Magjistraturës), vlerësim i parë konsiderohet ai i gradimit. Për këta gjyqtarë, për efekt të pasjes së dy vlerësimeve, vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, si vlerësim i dytë për efekt të procedurës së lëvizjes paralele, do të fillojë vetëm nëse ata nuk janë përfshirë në programet e vlerësimit periodik të miratuara nga Këshilli (vlerësimi 3-vjeçar 2017-2019 ose vlerësim i përshpejtuar vitit kalendarik 2021).

- Për gjyqtarët që e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që gjatë kësaj periudhe kanë më pak se 1 vit pune si gjyqtar (duke përjashtuar stazhin profesional të kryer në kuadër të Shkollës së Magjistraturës), vlerësim i parë konsiderohet ai periodik 3-vjeçar i filluar ose që mund të fillojë sipas programeve të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli. Për këta gjyqtarë vlerësimi i dytë do të konsiderohet ai i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022.

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, por që janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, gradimi nuk mund të realizohet, prandaj për këta gjyqtarë vlerësim i parë do të konsiderohet ai periodik, sipas programit të vlerësimeve për vitin 2021, që i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019. Për këta gjyqtarë vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, vlerësim që Këshilli ka marrë përsipër ta kryejë në rastet kur kandidohet për lëvizje paralele. Por ky i fundit do të konsiderohet i mundshëm për t’u kryer vetëm në rastin kur kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga vlerësimi i fundit, në këtë rast nga viti 2019 (dhe jemi në kushtet e mundësisë për ta kryer).

- Për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, por që nuk janë përfshirë në programin e vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, (gradimi) nuk mund të realizohet dhe as vlerësimi tjetër periodik, prandaj për këta gjyqtarë do të ketë vetëm një vlerësim të mundshëm për t’u kryer (sipas skemës së re të vlerësimit), që i përket vitit të fundit kalendarik të ushtrimit të detyrës, pra vlerësim i përshpejtuar i detyruar për vitin 2022.

- Për gjyqtarët që janë emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të cilët verifikimi i pasurisë e figurës është bërë prej tij, vlerësim i parë etik–profesional i mundshëm për tu kryer, do të konsiderohet ai i parashikuar në programin e vlerësimit për vitin 2023.

Bazuar në kriteret e mësipërme, lidhur me mundësinë e vlerësimeve të kryera sipas skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve, për secilin gjyqtar në veçanti, konkludohet si më poshtë:

1. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i emëruar gjyqtar në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtari ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022. Ky gjyqtar është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023.

2. Për gjyqtaren {...} , gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht e komanduar në Gjykatën e Lartë, Këshilli sapo miratoi vendimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të saj për shkak se gradimi ka qenë i pamundur. Ndërkohë, për këtë gjyqtare, Këshilli, me vendimin nr. 7, datë 18.01.2023 ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2018 – 2020. Përveç këtij vlerësimi, për këtë gjyqtare nuk mund të fillohet vlerësim i përshpejtuar i detyruar, sepse nuk kanë kaluar 2 vjet nga vlerësimi i fundit (ky mund të bëhet vetëm për vitin 2023) dhe as mund të ketë gradim sepse siç relatova më përpara, Këshilli e ka marrë tashmë vendimin. Për këtë gjyqtare ka vetëm një vlerësim dhe nuk mund t'i kryhet një i dytë.

3. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i emëruar gjyqtar në datën 21.10.2013, mund të ketë dy vlerësime etike profesionale, për të cilat Këshilli ka filluar procedurat e vlerësimit sipas programit të miratuar, konkretisht kemi një procedurë vlerësimi me qëllim gradimi të filluar dhe njëkohësisht kemi edhe një procedurë të dytë vlerësimi 3-vjeçar, për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019. Ky gjyqtar mund të ketë dy vlerësime.

4. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i emëruar gjyqtar në datën 24.11.1993, gradimi nuk mund të realizohet, pasi tashmë Këshilli e mbajti qëndrimin e tij lidhur me përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar për

periudhën 2013 – 2016. Ndërkohë, pas kësaj periudhe dhe pas vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari {...} ka ndjekur vitin akademik pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën 2020 – 2021, sipas kurikulave të miratuara për programin teorik e praktik, në përfundim të të cilit është vlerësuar në nivelin “Mirë” duke i kaluar mangësitë e parashtruara nga KPK-ja. Vlerësimi përfundimtar në nivelin “Mirë” është miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 20, datë 15.07.2021. Ky vlerësim i është përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe është rimarrë në shqyrtim nga KPK-ja, i cila me vendimin nr. 444, datë 16.09.2021 e ka konfirmuar në detyrë gjyqtarin, ku për kriterin e aftësive profesionale ka pranuar vlerësimin e bërë nga Shkolla e Magjistraturës. Në këto kushte, ky nivel vlerësimi “Mirë”, i miratuar nga organi kompetent, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, përbën vlerësimin e vetëm dhe të fundit të mundshëm në kohë të realizuar për gjyqtarin {...}, për të cilin Këshilli nuk mund të fillojë vlerësim tjetër qoftë për periudhën para vitit 2020, në kushtet kur Shkolla e Magjistraturës e ka vlerësuar aftësinë profesionale dhe menaxheriale të gjyqtarit deri në vitin 2021, as për periudhën e mëpasshme, sepse nuk plotësohen kushtet për fillimin e një vlerësimi të përshpejtuar të detyruar për vitin 2022, pasi nuk kanë kaluar 2 vjet nga vlerësimi i fundit. Për këtë gjyqtar, Komisioni ka konkluduar që ka vetëm një vlerësim, ai që i ka bërë nga Shkolla e Magjistraturës, i përcaktuar në nivelin “Mirë”.

5. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i emëruar gjyqtar në datën 04.09.1999, mund të ketë një vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit që përkon me vitin kalendarik 2022. Ky gjyqtar nuk e ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar e për pasojë gradimi i tij sipas skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve nuk mund të kryhet. Nga ana tjetër ky gjyqtar nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve periodike të miratuara nga Këshilli. Prandaj për këtë gjyqtar mund të ketë vetëm 1 (një) vlerësim etik-profesional, sipas skemës së vlerësimit të gjyqtarëve.

6. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, e emëruar gjyqtare në datën 20.10.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

7. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i emëruar gjyqtar në datën 21.10.2013, gradimi si vlerësim i parë nuk mund të realizohet, në kushtet kur vendimi i KPK-së nr. 479, datë 03.12.2021, për konfirmimin e tij në detyrë është ankimuar nga Komisioneri Publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, e si i tillë nuk ka marrë formë të prerë. Ky gjyqtar është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar 2017 – 2019 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit periodik 3-vjeçarë 2017 – 2019, që do të konsiderohet edhe vlerësim i parë për efekt të lëvizjes paralele. Për këtë gjyqtar nuk mund të fillojë vlerësim i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, pasi në vlerësim të Komisionit ai ka punuar përgjatë këtij viti nga 1 janari 2022 deri në 20.06.2022 si gjyqtar i shkallës së parë dhe në 6-mujorin tjetër si gjyqtar i skemës së delegimit në apel. Në kushtet kur rregullat për vlerësimin e gjyqtarëve të skemës së vlerësimit për gjyqtarët e deleguar nuk janë miratuar ende nga Këshilli dhe periudha e ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar i shkallës së parë është më pak se 1 vit brenda vitit 2022, vlerësim i dytë për këtë gjyqtar nuk është i mundshëm për t'u kryer. Prandaj për këtë gjyqtar mund të ketë vetëm 1 (një) vlerësim etik profesional, sipas skemës së vlerësimit të gjyqtarëve.

8. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e emëruar gjyqtare në datën 25.09.2015, gradimi si vlerësim i parë nuk mund të realizohet, në kushtet kur ajo nuk e ka kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar. Kjo gjyqtare është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar 2017 – 2019 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit periodik për këtë periudhë vlerësimi e cila do të konsiderohet edhe vlerësim i vetëm për efekt të lëvizjes paralele. Për këtë gjyqtare nuk mund të fillojë vlerësim i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, sepse ajo ka qenë me leje prindërore të papaguar nga data 14.06.2021 deri në datën 01.11.2022. Ajo ka punuar gjatë vitit 2022 vetëm dy muaj, pra më pak se 1 vit brenda vitit 2022. Prandaj për këtë gjyqtare mund të ketë vetëm 1 (një) vlerësim etik profesional, sipas skemës së vlerësimit të gjyqtarëve.

9. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, e emëruar gjyqtare në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022. Kjo gjyqtare është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023.

10. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e emëruar gjyqtare në datën 10.11.2011, mund të ketë 2 (dy) vlerësime, pasi Këshilli me vendimin nr.364, datë 13.09.2022 e ka miratuar një vlerësim të gjyqtares, gradimin e saj, ndërkohë që vlerësimi 3-vjeçar periodik është filluar dhe është në proces (për vitet 2017 – 2019).

11. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i emëruar gjyqtar në datën 20.03.2007, gradimi si vlerësim i parë për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 nuk mund të realizohet, pasi ky gjyqtar nuk e ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky gjyqtar është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar 2017-2019 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit periodik 3-vjeçar 2017 – 2019, që do të konsiderohet edhe vlerësim i parë për efekt të lëvizjes paralele. Për këtë gjyqtar, sipas programit të vlerësimeve të miratuar nga Këshilli për vitin 2023, mund të fillojë vlerësim i dytë i përshpejtuar i vitit kalendarik 2022, pasi kanë kaluar 2-vjet nga vlerësim i fundit (periudha e fundit e vlerësimeve). Prandaj për këtë gjyqtar mund të ketë 2 (dy) vlerësime etike profesional, sipas skemës së vlerësimit të gjyqtarëve.

12. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e emëruar në datën 09.01.2020, aktualisht e komanduar në Gjykatën e Lartë, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare përvojën profesionale e ka plotësuar gjatë vitit 2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023 (ku janë përfshirë të gjithë gjyqtarët që kanë plotësuar periudhën 3-vjeçare në vitin 2022).

13. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e emëruar gjyqtare në datën 31.10.2014, gradimi si vlerësim i parë nuk mund të realizohet, në kushtet kur ajo nuk e ka kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar. Kjo gjyqtare është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar 2017 – 2019 dhe për të ka filluar procedura e vlerësimit periodik 3-vjeçar 2017 – 2019, që do të konsiderohet edhe vlerësim i parë për efekt të lëvizjes paralele. Për këtë gjyqtare, sipas programit të vlerësimeve të miratuar nga Këshilli për vitin 2023, mund të fillojë vlerësim i dytë i përshpejtuar i vitit kalendarik 2022, pasi kanë kaluar 2 vjet nga vlerësim i fundit (periudha e fundit e vlerësimeve). Prandaj për këtë gjyqtare mund të ketë 2 (dy) vlerësime etike profesional, sipas skemës së vlerësimit të gjyqtarëve.

14. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e emëruar në datën 20.10.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim pasi kjo gjyqtare nuk ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

15. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e emëruar në datën 09.01.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare përvojën profesionale e ka plotësuar në vitin 2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për këtë vit do duhet të përfshihet për vitin 2024).

16. Për gjyqtaren {...} , siç e shihni, ka dy vendime, pra ajo i ka dy vlerësime, të miratuara me vendimet nr. 297 dhe nr.298, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

17. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i emëruar gjyqtar në datën 21.10.2003, mund të ketë dy vlerësime etike profesionale, për të cilat Këshilli ka filluar procedurat e vlerësimit, konkretisht një gradim për periudhën 2013 – 2016. Ka filluar Këshilli edhe një vlerësim të dytë të përshpejtuar për periudhën e vlerësimit që përkon me vitin kalendarik 2021, në kushtet kur ky gjyqtar ka aplikuar edhe për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.

18. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, nuk mund të bëhet vlerësim sepse ai është emëruar më 20.10.2020 dhe nuk plotëson nevojën 3-vjeçare profesionale.

19. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, e emëruar gjyqtare në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022 dhe është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023.

20. Për gjyqtaren {...}, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi është emëruar në datën 20.10.2020 dhe nuk e ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

21. Për gjyqtaren {...}, është emëruar në datën 09.01.2020 dhe nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare e ka plotësuar përvojën 3-vjeçare profesionale në datën 09.01.2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023 (ku janë përfshirë të gjithë gjyqtarët që kanë plotësuar periudhën 3-vjeçare në vitin 2022).

22. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, është emëruar në datën 20.10.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi edhe ai nuk ka përvojën 3-vjeçare profesionale.

23. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e emëruar gjyqtare në datën 10.11.2011, mund të ketë dy vlerësime etike profesionale. Vlerësimi i parë është ai i gradimit, në kushtet gjyqtarja ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, proces i cili fillon menjëherë me përparësi me dërgimin e dosjes nga organet e rivlerësimi. Ndërkohë gjyqtarja është në proces vlerësimi periodik 3-vjeçar për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019 (vlerësimi i dytë).

24. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i emëruar gjyqtar në datën 10.11.2011, mund të ketë dy vlerësime etike profesionale. Vlerësimi i parë është ai i gradimit, në kushtet gjyqtari ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë dhe vlerësimi i dytë është ai periodik 3-vjeçar për vitin 2017 – 2019 vlerësim i cili është përfunduar nga relatorja dhe është për shqyrtim në mbledhjen plenare.

25. Për gjyqtaren {...}, nuk mund të ketë vlerësim. Është emëruar në datën 20.10.2020 dhe nuk plotëson përvojën 3-vjeçare profesionale.

26. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i emëruar në datën 20.11.2015, gradimi është i pamundur sepse Këshilli sapo e miratoi vendimin për mosfillimin e procedurës së gradimit pasi ai nuk ka më shumë se një vit punë. Ndërkohë që ai është caktuar për të ushtruar funksionin e gjyqtarit më 10.02.2017, pra është caktuar jashtë periudhës së vlerësimit, është përfshirë në programin e vlerësimit 3-vjeçar 2017 – 2019 i cili është në proces. Njëkohësisht mund t'i bëhet edhe vlerësimi i dytë për vitin 2022 sepse kalojnë më shumë se dy vjet nga 2019-ta. Pra është gjyqtar që mund të ketë 2 vlerësime.

27. Për gjyqtaren {...}, është përfshirë në programin e vlerësimit për vitin 2023. Për shkak të përvojës profesionale mund t'i bëhet vetëm 1 vlerësim.

28. Për gjyqtarin {...}, për gradimin Këshilli ka vendosur përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së gradimit sepse ai nuk mund të realizohej. Ndërkohë që, vendimi ka marrë formë të prerë pasi u shqyrtua edhe nga Gjykata e Apelit

Administrativ. Ky gjyqtar është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2021 dhe është në procedurë vlerësimi për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019, ndërkohë që, mund t'i bëhet edhe një vlerësim i përshtetshëm për vitin 2022. Prandaj ky gjyqtar mund të ketë dy vlerësime.

29. Për gjyqtaren {...}, Këshilli ka miratuar një raport vlerësimi për periudhën e gradimit 2013-2016, që do të konsiderohet edhe vlerësimi i parë në kuadër të lëvizjes paralele. Ndërkohë që, periudhën 2017 – 2019 gjyqtarja është në procedurë vlerësimi dhe asaj mund t'i bëhen dy vlerësime.

30. Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e emëruar në datën 09.01.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi gjyqtarja e ka plotësuar përvojën 3-vjeçare gjatë vitit 2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për këtë vit.

31. Për gjyqtarin {...}, mund të ketë një vlerësim. Është në programin e vlerësimit për vitin 2023, sepse ka 3 vjet përvojë profesionale të plotësuar përgjatë vitit 2022.

32. Për gjyqtarin {...}, nuk mund të ketë vlerësim, pasi gjyqtari e ka plotësuar përvojën 3-vjeçare në datën 09.01.2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023.

33. Për gjyqtaren {...}, e emëruar më 20.10.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare nuk e ka plotësuar ende përvojën 3-vjeçare profesionale.

34. Për gjyqtaren Adelajda Gjuzi, Këshilli ka miratuar tashmë, me vendimet 35 dhe 36, dy raporte vlerësimi. Pra ajo i ka dy vlerësime.

35. Për gjyqtaren {...}, vlerësimi i parë nuk mund të realizohet, sepse ajo ende nuk e ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar. Është në program vlerësimi periodik 2017 – 2019, ndërkohë që nuk mund t'i fillojë procedura e përshtetshme për shkak se ajo ka marrë lejen e barrëlindjes më 17.11.2022, pra ka më pak se një vit pune brenda vitit 2022. Prandaj për këtë gjyqtare mund të ketë vetëm 1 (një) vlerësim etik profesional, sipas skemës së vlerësimit të gjyqtarëve.

36. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i emëruar gjyqtar në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtari ka 3-vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022. Ky gjyqtar është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023.

37. Për gjyqtarin {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i emëruar gjyqtar në datën 09.01.2020, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi ky gjyqtar e ka plotësuar përvojën 3-vjeçare profesionale më 09.01.2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023.

38. Për gjyqtaren {...}, e emëruar gjyqtare në datën 19.07.2019, mund të ketë vetëm një vlerësim etik profesional, pasi gjyqtarja ka 3 vjet përvojë profesionale, të plotësuar përgjatë vitit 2022. Kjo gjyqtare është pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023.

Për sa më sipër, në pikën e parë të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, sipas skemës së re të vlerësimit, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11 – nr. 24, datë 18.01.2023, sipas “Shtojcës I” bashkëngjitur këtij vendimi e cila përmban:

Listën e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime dhe që janë:

1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
2. Znj. Adelajda Gjuzi, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Listën e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime, që janë:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
5. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
6. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
7. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;
8. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
9. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
10. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, sipas skemës së re të vlerësimit, për

efekt të kandidimit në procedurat e shpallura në Tiranë e Durrës, sipas “Shtojcës II” bashkëngjitur këtij vendimi e cila përmban:

Listën e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim:

1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht e komanduar në Gjykatën e Lartë;

2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat (sipas interpretimit që u bë më herët në këtë relacion).

Listën e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim, që janë:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;

2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;

3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;

4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;

5. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;

6. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;

7. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;

8. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;

9. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;

10. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;

11. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Në pikën 3 të projektvendimit është parashikuar miratimi nga Këshilli i listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim sipas skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve, për pozicionet e shpallura për efekt të lëvizjes paralele dhe “Shtojca III” e këtij vendimi përmban bashkëngjitur:

Listën e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim:

1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;

2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, aktualisht komanduar ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;

3. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;

4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;

5. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;

6. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë;
7. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
8. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
9. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
10. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
11. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
12. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
13. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja e tij në fuqi, duke qenë para një akti me natyrë kolektive, me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj anëtarët për diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

(Zonja Shehu kërkon fjalën.)

Ilir Rusi: Besoj se ishte koha e mjaftueshme për të reflektuar, prandaj.

Faleminderit!

Zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Duke falënderuar paraprakisht relatoren dhe Komisionin e Vlerësimit për punën, se faktikisht është një punë shumë e madhe dhe evidentimi i kandidatëve që kanë, mund të kenë dy, kanë, mund të kenë një apo asnjë vlerësim, do doja të ngrija për diskutim çështjen e atyre kandidatëve të cilët rezultojnë që nuk kanë kaluar ende procesin e rivlerësimit kalimtar, pra të cilëve nuk mund t'u bëhet gradimi dhe nuk mund të kenë

vlerësimin e parë siç parashikon rregullorja, ndërkohë, nuk janë të përfshirë as në programin trevjeçar të rivlerësimit të Këshillit, dhe në këto kushte është referuar që nuk mund të ketë dy vlerësime për këta gjyqtarë, por mund të ketë vetëm një vlerësim të dytë që mund të jetë vlerësimi i përsheptuar (siç parashikon ligji dhe rregullorja).

Ndërkohë në rregulloren e Këshillit, pra në vendimin nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” kemi parashikuar në pikën 117 të tij se:

“117. Si vlerësim i parë për kriterin e renditjes së “dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, sipas rastit, konsiderohet: a) Gradimi sipas nenit 171, pika 5, të Ligjit për Statusin, për atë kandidat që ka kaluar me sukses, me vendim përfundimtar, procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016; ose në pamundësi të tij, b) Vlerësimi i fundit etik dhe profesional sipas sistemeve të vlerësimit që kanë qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin. Konvertimi i niveleve të vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional me ato sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (Ligjit për Statusin) bëhet sipas tabelës së mëposhtme: [...]” Më poshtë pastaj është tabela që bën edhe ekuivalentimin e niveleve.

Ajo që unë do doja të diskutoja me Këshillin është se për këta kandidatë që nuk mund t’u bëhet gradimi dhe nuk janë në programin trevjeçar të vlerësimit, a do të marrim dhe të referojmë si vlerësim të parë vlerësimin sipas sistemeve të vlerësimit që ka qenë në fuqi para ligjit “Për statusin”? Të paktën kështu thotë rregullorja. Apo do t’i qëndrojmë standardit që do t’i referohemi vetëm skemës së re të vlerësimit të ngritur sipas ligjit që është në fuqi, ligjit “Për statusin”.

Unë do doja në fakt ta hidhja për diskutim dhe më pas mund të... Nuk është se kam paraprakisht ndonjë mendim, pasi do doja që të dëgjoja edhe kolegët dhe të japim zgjidhjen më të mirë të mundshme situatës.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, unë mendoj që kjo situatë është zgjidhur nga rregullorja. Për fakt kemi qenë ne që e kemi krijuar, kuptohet, në bashkëpunim edhe me partnerët tanë, dhe këtë situatë juridike e kemi zgjidhur. Që do të thotë, në mungesë të gradimit, jemi të detyruar të marrim vlerësimin e fundit etik dhe profesional sipas sistemit të vlerësimit që ka qenë në fuqi para ligjit “Për statusin”. Pra vlerësimi i parë do të jetë vlerësimi që ka bërë ish-KLD-ja dhe pastaj, në mungesë të gradimit, i cili për fat të keq duhet të ishte mbaruar për të gjithë ata që kanë mbaruar tashmë kontrollin nga ana e vetingut, por që për efekt të burimeve të cinguara njerëzore në KLGJ, ka qenë e pamundur ta finalizonim, sepse detyrimi kryesor i KLGJ-së është që gradimi të jetë i përfunduar për të gjithë (në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”). Në mungesë të kryerjes, të përmbushjes së këtij detyrimi, rregullorja ka përzgjedhur si vlerësim të fundit etik atë që dikur ka bërë KLD-ja. Kështu që kjo situatë, mendoj, nëse do të respektojmë këtë akt rregullativ, këto janë rregullat e lojës dhe ne duhet të ecim në zbatim të kësaj rregulloreje. Ky është mendimi im për këtë pjesë. Në qoftë se do të vazhdojmë pastaj për më tej.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Alban Toro: Pastaj, do të justifikojmë faktin pse nuk e marrim parasysh rregulloren (flasim për kategorinë e atyre që s’kanë bërë gradimin, për atë kategori po flasim).

Brikena Ukperaj: Mundem?

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Në listën e gjyqtarëve kishte dy kategori gjyqtarësh që kishin aplikuar dhe që nuk e kishin kaluar procesin e rivlerësimit. Ishin gjyqtarë të cilët kishin vlerësime të mëparshme, ka dhe gjyqtarë që nuk e kanë kaluar përsëri vlerësimin por kanë vlerësime të mëpasshme. Pra në qoftë se ne do mbajmë standardin që për gjyqtarët

që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit do marrim vlerësimin e fundit sipas sistemit të vjetër, atëherë i bie që ka gjyqtarë që nuk kanë vlerësime, do të penalizohen. Por nga ana tjetër, këta gjyqtarë, siç është zonja Kape për shembull, këta gjyqtarë janë gjyqtarë (mund të jetë edhe ndonjë gjyqtar tjetër, por ajo më vjen në mendje – zonja Shkreli, për shembull), këta janë gjyqtarë që mund të kenë dy vlerësime sipas skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve dhe rregullorja e vlerësimit për lëvizjen paralele parashikon që, ti, gjyqtarëve duhet t'i garantosh të kenë mundësinë të vlerësohen sipas dy vlerësimeve të mundshme të fundit. Pra kur ne mund t'iu bëjmë gjyqtarëve një vlerësim të 2017 – 2019, mund t'iu bëjmë edhe një vlerësim të 2022, nuk ka kuptim që të marrim një vlerësim të mëparshëm (edhe pse s'ka kaluar gradimin), s'ka kuptim se nuk llogaritet.

Marrim tani rastin e gjyqtarëve që kanë vlerësime të mëparshme, por nuk janë përfshirë në programe dhe nuk kanë vlerësime të tjera dhe këtu bëhet fjalë për dy gjyqtarë (zoti {...} dhe zoti {...}), janë vetëm këta dy gjyqtarë (zoti {...} s'e ka kaluar por zoti {...} e ka kaluar procesin e rivlerësimit). Për zotin {...} kemi thënë që mund të ketë një vlerësim. Po ta keni parasysh aktin, Komisioni nuk ka marrë përsipër të përcaktojë listën e gjyqtarëve që kanë dy vlerësime sipas skemës së vlerësimit të vjetër. Është detyrë e relatorit. Nëse relatori do të vlerësojë që do të konsiderojë si vlerësim të parë një vlerësim të vjetër, mund ta bëjë. Ne kemi marrë përsipër të përcaktojmë listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime sipas skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve. Pra themi, që me këtë skemë, ne si Komision, se ne jemi zbatues të skemës para se t'ia propozojmë Këshillit, këta janë gjyqtarë që mund të kenë një, mund të kenë dy dhe nuk kanë asnjë vlerësim. Nëse ka gjyqtarë që kanë vlerësime të vjetra, relatori mund t'ia konsiderojë vlerësimin e vjetër dhe mund t'i konsiderohet një vlerësim të dytë sipas skemës dhe pastaj Këshilli ta vlerësojë.

Nga ana tjetër, dua të kujtoj që i njëjti parashikim është edhe tek rregullorja e ngritjes në detyrë, por tek rregullorja e ngritjes në detyrë nuk i morëm parasysh fare vlerësimet e vjetra, sepse garantuam një standard më të lartë për gjyqtarët që aplikonin për ngritje në detyrë. Thamë, do kalosh vetingun dhe do të bëhet edhe gradimi, edhe pse ai gjyqtar nuk e kishte atë gradimin dhe vlerësimin e përshpejtuar e kishte realizuar,

vlerësimi i fundit ekzistonte, nuk i morëm parasysh. Ky ka qenë diskutimi. Gradimi u bë më vonë, nuk ishte në atë moment.

Nëse relatori përkatës i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës do të vlerësojë që për një gjyqtar ka një vlerësim të parë për gjyqtarin që s'ka gradim (dhe bëhet fjalë vetëm për dy gjyqtarë), që ka një vlerësim të parë që e ka bërë ish-KLD-ja në vitin 2009 dhe do t'ia marrë në konsideratë këtë vlerësim, dhe vlerësim të dytë do marrë një sipas skemës, kjo është e relatorit.

Alban Toro: Titullin e ke: Mbi miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asgjë.

Brikena Ukperaj:sipas skemës së re të vlerësimit.

Alban Toro: Po pra, dhe relatori këtë e ka të detyrueshëm. Do ta marri dhe do përcaktojë kush janë me dy, kush është me një, kush është pa asnjë.

Brikena Ukperaj: Alban, dakord!

Në qoftë se Këshilli do të bjerë dakord që do përfshijë edhe vlerësimet e vjetra, patjetër.

Alban Toro: E kemi bërë vetë me rregullore.

Brikena Ukperaj: Ta them unë pse e bëmë atë rregullore.

Patjetër! (*ripërsëritet*)

Rregullorja u bë në një moment kur ne nuk e kishim filluar ta zbatonim fare skemën e vlerësimit.

Të lutem, rregullorja nuk thotë asgjëkund tjetër që ti do marrësh vlerësimet periodike trevjeçare. Më thuaj, ku e thotë? Në asnjë moment. Sepse skema e vlerësimit s'kishte filluar të funksiononte Alban, kur e miratuam rregulloren. Por ama ne kemi ecur

me skemën e re të vlerësimit. Kemi gjyqtarë që i kemi në program 2017 – 2019, kemi dhe vlerësime të 2022.

Nëse do t'i marrim parasysh vlerësimet e vjetra si vlerësim të parë, i bie që gjyqtarët që janë në program 2017 – 2019 dhe 2022, të kenë një vlerësim.

Alban Toro: Ta ka thënë rregullorja që gradimi duhet të jetë i pari. Si t'i them unë të kalojë tek i dyti, kur ti s'ia ke bërë akoma gradimin?!

Brikena Ukperaj: Po si mund ta përjashtoj një gjyqtar nga lëvizja paralele, kur ai nuk e ka kaluar vetingun, por mund t'i bëhen dy vlerësime? Pse ta përjashtoj? E kemi gjëkundë që për lëvizjen paralele duhet të kalohet...

(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)

Brikena Ukperaj: Rregullorja ka parashikuar situatën kur skema e vlerësimit nuk do të mund të funksiononte. Por unë, kur kam gjyqtarë me 2017 – 2019 në program dhe me vlerësime, nuk mund t'i them gjyqtarit që ti do hiqesh, sepse nuk e ke kaluar vetingun, sepse vetingu nuk është kusht për lëvizje paralele. Në qoftë se nuk është kusht, ne do të llogarisim dy vlerësimet më të fundit. Nëse gjyqtari nuk e ka kaluar vetingun, ai nuk ka asnjë vlerësim të mëparshëm, do t'i bëhet 2017 – 2019 dhe 2022. Nëse Këshilli mendon që do të futen edhe vlerësimet e mëparshme, patjetër, kemi dy gjyqtarë, i fusim në listë. Është zoti Skënderi dhe zoti {...} që kanë vlerësime të 2007. Por mos harro, për zotin {...}, ai vlerësim që është “Shumë mirë”, kur erdhi puna tek 2016, shkoi në... Sa shkoi në 2016? “Pamjaftueshëm”! 2021 “Mirë”.

Ne mbajtmë qëndrimin që lidhur me vlerësimet e vjetra para gradimit, në kushtet kur skema e vlerësimit ka filluar të funksionojë dhe kemi mundësi për t'i bërë me dy vlerësime gjyqtarët, të mos i konsiderojmë.

Ilir Rusi: Zonja Plaku!

Irena Plaku: Gjithashtu mendoj që për rastet që diskutohen për këto dy gjyqtarë, vetë rregullorja parashikon që niveli i vlerësimit nënkupton rezultatin e përgjithshëm të vlerësimit duke përfshirë edhe atë të gradimit. Çka do të thotë që rregullorja e ka parashikuar të domosdoshme që të ketë gradimin. Ne nuk mund të bëjmë procedurë vlerësimi të parë, pa kaluar procedurën, pa gradim. Të paktën kështu është rregullorja e shprehur. Kështu që, nuk mund të marrim neve.. (e ndërpret mendimin). Është pika “e” tek përkufizimet. Thotë: Niveli i vlerësimit nënkupton rezultatin e përgjithshëm të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit sipas sistemit të vlerësimit, përfshirë edhe atë të gradimit. Po t’i referohemi rregullores ta thotë e përfshin atë. Nuk mund ta heqësh atë.

(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Klodian Kurushi: A mundet të them edhe unë një mendim për këtë pjesë?

Ilir Rusi: Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Fillimisht, kur morëm iniciativën për të realizuar mbushjen e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet mekanizmit të lëvizjes paralele, e kemi parasysh edhe nevojën që e dikton edhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe kohën që ne e kemi kundër, domethënë të përshpejtojmë sa më shpejt dhe sa më saktë, dhe sa më qartë, pa deroguar në cilësi procedurën e gjyqtarëve që përmbushin kushtet për të bërë lëvizjen paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Fillimisht, pasi morëm listën e kandidatëve që kanë kandiduar për lëvizje paralele, menjëherë më shkoi mendja që të paktën dy gjyqtarë, siç janë konstatuar këtu në këtë relacion, e kanë përmbushur një detyrim ligjor, kanë dy vlerësime, dhe mendova që edhe në pjesën e kandidatëve të tjerë në “pole (pozicionet)” ku këta kandidatë kandidonin, nuk do kishte pengesa që këta kandidatë të vazhdonin më tej procedurën dhe të mbaronin punë (po themi, me fjalë të thjeshta) sa më shpejt lëvizjen e tyre paralele për të përmbushur një nevojë që ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më tej, pasi lexova projektvendimin dhe relacionin përkatës, pashë një mos siguri tek vetja ime se si duhet të përcaktojmë radhën, që për mua është e rëndësishme, radhën e vlerësimeve, sepse besoj se ky është edhe diskutimi sot, të përcaktojmë radhën e vlerësimeve. Sa vlerësime duhet të ketë? Nëse kanë dy, kush është radha? Kush e merr të parën si radhë? A e shmangim dot në këtë rast neve gradimin? Të paktën kur lexova rregulloren them: -jo, nuk e shmangim dot. Gradimi duhet të jetë vlerësimi i parë. Kështu thotë rregullorja.

Unë ndoshta mund të mos dakordësohem me atë çfarë është vendosur, por gradimi është i pari, dhe në mungesë të gradimit... flasim gjithmonë për gjyqtarët që kanë një periudhë mundësie që të përfshijnë edhe gradimin në vlerësimin e tyre, pra për gjyqtarët e vjetër, mbi 10 vjet, mbi 15 vjet, flasim për këtë kategori, sepse do t'i ndajmë gjyqtarët në kategoritë përkatëse. A mund ta shmangim gradimin tek këta gjyqtarë? Pra mund t'ia lejojmë vetes ne dhe të themi: – shiko, ai nuk e ka kaluar vetingun. Nuk është shkak. Unë e di, dhe ne të gjithë e dimë që nuk është shkak, moskalimi i vetingut të na bëhet pengesë neve për lëvizjen paralele. Dakord në këtë pjesë. Por a duhet apo nuk duhet për këta gjyqtarë gradimi apo jo?

Neni 171/5, siç e kuptoj unë, kërkon gradimin e gjyqtarëve, dhe është element shumë i rëndësishëm. Edhe rregullorja thotë gradimin e gjyqtarëve. Në mungesë të gradimit, -thotë për gjyqtarët e vjetër, do t'i referohemi vlerësimeve më të mëparshme të KLD-së. Pra kjo është në mungesë. Pra gradimin e kemi përcaktuar neve në rregulloren tonë përkatëse që është vlerësimi i parë. Mirë ose keq, këto janë rregulla që i kemi vendosur neve, dhe ai është vlerësimi i parë.

Vijojmë më tej. Pra për mua, unë mendoj që nuk shmanget dot kjo pjesa e gradimit, për sa kohë është vlerësimi i parë. Ka edhe dilema, ka edhe diskutime. Themi: - po mirë, po për ata gjyqtarët që nuk mund t'u bëhet gradimi? Edhe kjo është një pyetje. Kam përshtypjen se kemi gjetur zgjidhje këtu. Nuk mund t'i bëhet gradimi për efekte objektive që s'mund t'i bëhet. Si për shembull? Rasti i {...} (se po marrë këtë emër), atij objektivisht nuk mund t'i bëhet gradimi. Jo se nuk duam ne; nuk e pengojmë ne; por s'i bëhet, sepse në 2016, as nuk e ka përmbushur 1 vit në 2016. Çfarë do bëjmë për këtë?

S'ka gradim, nuk ka radhë për të. Do fillojë radha sipas skemës së re (2017 – 2019 dhe një vlerësim tjetër). Dakordësohem me këtë pjesën.

Po sikundër ka edhe gjyqtarë që e kanë filluar detyrën në 2013 – 2014. A mund t'i bëjmë dy vlerësimet e fundit 2017 – 2019, dhe më mbrapa? Kemi gradimin. Nuk na lë gradimi. Më mbrapa çfarë do na ndodhi? Këta bëhen me dy, marrin dhe gradimin, bëhen me tre, me katër. Të tjerët janë, po themi, në situata të pabarabarta.

Kemi edhe gjyqtarë që kanë me 20 vjet, 22, 23 vjet, edhe këta të vjetër. Them: -jo, këta s'i bëjmë dot me dy vlerësime. Po pse nuk i bëjmë dot me dy vlerësime? Po kanë mbi 15 vjet me çfarë e kuptova unë, dhe për 15 vjet duhet që për 5 vjet të fillojë procedura e rivlerësimit. A t'i penalizojmë edhe këta gjyqtarë? T'i themi: -jo, shiko, ti je më i vjetri ndër të gjithë këta të rinjtë, por ty nuk të bëjmë dot me dy vlerësime ne; ty do të bëjmë me një vlerësim, se kështu janë rregullat. Po në këtë rast çfarë bëjmë? Po i biem kundër rregullave që kemi miratuar vetë. Për këta që janë të vjetër, nëse s'ka mundësi gradimi, siç thotë rregullorja, do bëjmë vlerësimin e parë, të fundit të KLD-së së vjetër. Nuk mund t'i përjashtojmë ata të cilët nuk kanë as faj në rend dhe në mungesën e bërjes së procesit të vetingut. Në këtë pikë, mendoj që duhet të jemi gjithëpërfshirës, në aspektin që t'i trajtojmë kolegët në mënyrë të barabartë. Mendimi im personal është që unë nuk e shmang dot vetingun, domethënë gradimin, procesin e gradimit. Nuk e kanë ata gjyqtarë. Do mbesin me një vlerësim. Nuk e shmangim dot, në rend, në radhë. Domethënë duhet patjetër një vlerësim gradimi dhe në rast se ai nuk e ka, do zbatojmë dispozitat e rregullores, do shikojmë atë që është më përpara. Për gjyqtarët që nuk u bëhet gradimi, objektivisht do marrim vlerësimet e tjera. Por rendin, unë mendoj që nuk e zgjidhim dot ne. Radhën nuk e zgjidhim, radha është e përcaktuar në ligj dhe në rregullore.

Brikena Ukperaj: Klodi, se pak a shumë, ti bie dakord me këtë propozim që kemi sjellë ne, por për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar vetingun dhe nuk kanë vlerësime të mëparshme, do të marrim radhën sipas vlerësimeve të skemës (2017 – 2019 dhe 2022). Apo mendon që këta që s'kanë kaluar gradimin nuk kanë fare një vlerësim, do të kenë vetëm një?

Klodian Kurushi: Domethënë, unë jam këtu. Ata që janë në proces vetingu, radhën e kanë, e duan patjetër vlerësimin e vetingut, gradimin, sepse është në radhë i përcaktuar në ligj. Nëse s'e kanë këtë, do të bëjmë atë që është më përpara, dhe një vlerësim të përshpejtuar ('më përpara', që është vendimi i KLD-së).

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Klodian Kurushi: Nuk i bëjmë dot të dytin, sepse radhën e ka përcaktuar ligji. Vetingun nuk e shmangim dot. Gradimin si proces nuk e shmangim dot. Nuk bëjmë dot dy radhë, tre, katër, pesë radhë më mbrapa.

Brikena Ukperaj: Gradimi, si një proces vlerësimi, bëhet në momentin kur mbaron procesi i vlerësimit dhe vendimi merr formë të prerë. Dakord?

Tani, për gjyqtarët që nuk kanë vlerësime të vjetra, dhe kemi gjyqtarë që nuk kanë vlerësime të vjetra, por ama nuk kanë kaluar as procesin e rivlerësimit kalimtar, ecuria e skemës së vlerësimit mundëson dy vlerësime të fundit, që është periodiku 2017 – 2019 dhe është 2022. Pra për këta gjyqtarë ne nuk mundet (të paktën dhe qëndrimi që kemi mbajtur në Komision) nuk mundet dot t'i përjashtojmë, sepse t'i s'ke kaluar vetingun, sepse ai të konsiderohet vlerësim i parë. Jo! Unë vërtet s'e kam kaluar, por ashtu si ata gjyqtarët e vjetër nuk kanë faj që s'e kanë kaluar, edhe këta nuk kanë faj që s'e kanë kaluar. Prandaj kur skema e vlerësimit funksionon, vlerësimi periodik 2017 – 2019 bëhet; vlerësimi 2022 bëhet. Por që për këta gjyqtarë nuk ka diskutim.

Ajo që është e diskutueshme është vetëm çështja që ngre Albani dhe Marçela. Nëse për gjyqtarët e vjetër që s'e kanë kaluar vetingun, do t'ja u konsiderojmë një vlerësim të bërë sipas... në rregullore është e vërtetë që ne e kemi shkruar këtë gjë, që vlerësimi i parë është gradimi dhe nëse ka kaluar gradimin, do të konsiderohen vlerësimet e vjetra sipas KLD-së.

Çfarë bëjmë në Komision? Ne diskutuam vetëm mundësinë e vlerësimit sipas skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve, pa llogaritur se çfarë ishin vlerësimet e bërë nga ish-KLD-ja, dhe vlerësuam që për zotin Skënderi mund të kishte vetëm një vlerësim

sipas skemës së re. Patjetër që ai e ka edhe një vlerësim tjetër 2007 – 2009, e ka një vlerësim sipas skemës dhe është vlerësimi "Shumë mirë". Nëse Këshilli do vlerësojë që këto vlerësime të vjetra do t'i përfshijmë, në titullin e aktit e heqim "nga skema e vlerësimit", nuk ka asnjë problem dhe kalon tek lista e gjyqtarëve që mund të kenë dy vlerësime. E njëjta gjë është edhe për zotin {...} , por ama për zotin {...} duhet ta diskutojmë mirë sepse zoti {...} ka një vlerësim "Shumë mirë"....

Jo, për të gjithë gjyqtarët, një standard Alban.

Nëse zoti {...} ka një vlerësim "Shumë mirë", pastaj iu bë "Mjaftueshëm", pastaj shkoi në "Mirë"...

Jo, por do ta mbajmë diskutimin për të gjithë gjyqtarët njësoj, sepse do të vendosim standardet njëherë. Ky ishte i gjithë diskutimi për atë arsye.

Marçela Shehu: Mund të bëj një propozim?

Ilir Rusi: Po zonja Shehu!

Marçela Shehu: Atëherë, propozoj që tek vendimi për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, propozoj që të përfshihen si standard edhe gjyqtarët të cilët ende nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, të cilëve nuk mund t'u bëhet gradimi, por sipas vendimit nr. 320, datë 17.09.2020 të Këshillit, pika 117 e tij, në pamundësi të realizimit të gradimit, si vlerësim i parë mund t'i konsiderohet vlerësimi sipas sistemit të vlerësimit të vjetër që ka qenë në fuqi përpara ligjit "Për statusin". Për të krijuar standarde dhe një trajtim të barabartë për të gjithë gjyqtarët, vlerësoj që edhe gjyqtarët që nuk kanë gradimin si vlerësim të parë dhe që nuk janë të përfshirë në programin e mëvonshëm të miratuar nga Këshilli për vlerësimin trevjeçar, t'i konsiderohet pikërisht vlerësimi i vjetër si vlerësim i parë, për efekt të kandidimit në lëvizjet paralele.

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Shehu.

Irena Plaku: Kundër. I qëndroj propozimit që vlerësimi i parë të merret vlerësimi sipas rregullave të reja të përcaktuara për vlerësimin e gjyqtarëve.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Meqenëse ai propozimi im kam përshtypjen që s'ka për t'u marrë në konsideratë, unë jam dakord, pjesërisht dakord me këtë pjesën. Jam dakord domethënë. Domethënë, propozimi im ishte që të përfshihej në rend gradimi i parë si vlerësim.

Qartë! Mirë, jam dakord me këtë propozim.

Ilir Rusi: Kundër.

Por për shkak të shumicës së votave, miratohet propozimi i bërë nga zonja Shehu.

Brikena Ukperaj: Mundem tani zoti Rusi?

Ilir Rusi: Atëherë, për shkak të miratimit me shumicë votash të propozimit të bërë nga zonja Shehu, ftoj relatoren zonjën Ukperaj, për të bërë reflektimet përkatëse në projekt-akt.

Brikena Ukperaj: Atëherë, në titullin e projekt-aktit, togfjalëshi “sipas skemës së re të vlerësimit” hiqet, në kushtet kur ne vlerësuam dhe vlerësimet e vjetra.

Po kështu, në pikën 1 të projekt-aktit, në fjalinë e parë “1. Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime – “sipas skemës së re të vlerësimit”, hiqet - për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”, këto vazhdojnë.

Në pikën 2 të projekt-aktit, e njëjta fjalë “sipas skemës së re të vlerësimit”, hiqet.

Po kështu edhe në pikën e 3-të “sipas skemës së re të vlerësimit”, hiqet.

Ndërkohë, tek “Shtojca e parë”, tek lista e gjyqtarëve që mund të kenë dy vlerësime, do të futet zoti {...} dhe zoti {...}.

Jemi dakord? Me standardin që mbajti Këshilli.

Tek “Shtojca e dytë”, emri i zotit {...} hiqet nga lista e gjyqtarëve që kanë një vlerësim. Dhe po kështu, emri i zotit {...} hiqet nga lista e gjyqtarëve që mund të kenë një vlerësim, sepse e kemi shtuar tek “Shtojca e parë”.

Ndërsa, “Shtojca e tretë” nuk ndryshon.

Ndërkohë që relacionin, ne si Komision marrim përsipër që ta përditësojmë me ndryshimet që bëri sot Këshilli, me qëllim që edhe gjyqtarët nëse do të duan të shikojnë arsyet, ta kenë të shpjeguar shkaku pse.

Ilir Rusi: Atëherë, hedhim në votim projektvendimin me ndryshimet përkatëse të cilat erdhën si rrjedhojë e miratimit të propozimit dhe reflektimeve përkatëse nga ana e relatores.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi. (Lexohet përmbajtja e shtojcës):

Shtojca I

Lista e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime:

1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
2. Znj. Adelajda Gjuzi, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
5. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
6. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
7. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;
8. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
9. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
10. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
11. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;
12. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023, sipas Shtojcës II bashkëngjitur këtij vendimi. (Lexohet përmbajtja e shtojcës):

Shtojca II

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim:

1. Znj. {...} , gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht e komanduar ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
3. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;
5. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;
6. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
7. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
8. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
9. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
10. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

3. Miratimin e listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023, sipas Shtojcës III bashkëngjitur këtij vendimi. (Lexohet përmbajtja e shtojcës):

Shtojca III

Lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim:

1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (aktualisht e komanduar ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë);
3. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
5. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;
6. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë;
7. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
8. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
9. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;

10. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
11. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
12. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
13. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këtë pikë të rendit të ditës mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor